



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI “ISMAIL QEMALI” VLORE

STATUTI

I

UNIVERSITETIT “ISMAIL QEMALI” VLORE

**Miratuar me Urdhrin nr. 197, datë 01.04.2019, të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë,
i ndryshuar me Urdhërin nr. 287, datë 30.06.2025 të Ministrit të Arsimit dhe Sportit.**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

PËRMBAJTJA

KREU I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME.....	7
Neni 1. Personaliteti juridik.....	7
Neni 2. Baza ligjore.....	7
Neni 3. Roli dhe misioni.....	7
Neni 4. Qëllimet.....	8
Neni 5. Parimet e funksionimit.....	9
Neni 6. Zhvillimi i veprimtarisë.....	10
Neni 7. Mbrojtja juridike.....	11

KREU II

STRUKTURA ORGANIZATIVE.....	12
Neni 8. Universiteti.....	12
Neni 9. Njësitë kryesore.....	12
Neni 10. Njësitë bazë.....	12
Neni 11. Qendrat kërkimore-shkencore.....	14
Neni 12. Qendra studimore ndërdisiplinore.....	14
Neni 13. Struktura e brendshme e UV.....	15
Neni 14. Degët.....	17

KREU III

ORGANET DREJTUESE.....	18
Neni 15. Organet kolegiale dhe autoritetet drejtuese.....	18
Neni 16. Rregulla të përgjithshme.....	18
Neni 17. Senati Akademik.....	19
Neni 18. Mbarimi i mandatit të anëtarit të Senatit Akademik.....	20
Neni 19. Funksionet e Senatit Akademik.....	20
Neni 20. Bordi Konsultativ.....	22
Neni 21. Asambleja e personelit akademik.....	22
Neni 22. Komisionet e përhershme.....	22
Neni 23. Bordi i Administrimit.....	30
Neni 24. Mbarimi i mandatit të anëtarit të Bordit të Administrimit.....	31
Neni 25. Funksionet e Bordit të Administrimit.....	31
Neni 26. Rektorati.....	33
Neni 27. Dekanati.....	34
Neni 28. Këshilli i Etikës.....	35



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

KREU IV

AUTORITETET DREJTUESE.....	37
Neni 29. Klasifikimi i autoriteteve drejtuese	37
Neni 30. Rektori	37
Neni 31. Funksionet e Rektorit	38
Neni 32. Zëvendësrektori.....	41
Neni 33. Papajtueshmëria me funksionin e zëvendësrektorit.....	42
Neni 34. Drejtuesi i njësisë kryesore	42
Neni 35. Mbarimi i mandatit të dekanit	44
Neni 36. Zëvendësdekani	44
Neni 37. Papajtueshmëria me funksionin e zëvendësdekanit	44
Neni 38. Drejtuesi i njësisë bazë.....	45
Neni 39. Mbarimi i mandatit të përgjegjës të departamentit	46
Neni 40. Administratori i universitetit.....	47
Neni 41. Administratori i njësisë kryesore.....	48

KREU V

PERSONELI I INSTITUCIONIT.....	49
Neni 42. Struktura dhe organika.....	49
Neni 43. Personeli i UV-së.....	49
Neni 44. Personeli akademik.....	49
Neni 45. Statusi dhe trajtimi i veçantë i personelit akademik.....	52
Neni 46. Të drejtat, detyrat dhe përgjegjësitë e personelit akademik.....	52
Neni 47. Personeli akademik i ftuar.....	53
Neni 48. Viti akademik sabatik.....	53
Neni 49. Personeli ndihmësakademik.....	54
Neni 50. Personeli administrativ.....	55
Neni 51. Punësimi i personelit ndihmësakademik.....	55
Neni 52. Punësimi i personelit administrativ.....	55
Neni 53. Masat disiplinore.....	56
Neni 54. Procedura për dhënien e masave disiplinore.....	56

KREU VI

ORGANIZIMI I STUDIMEVE.....	58
Neni 55. Format e studimeve universitare.....	58
Neni 56. Ciklet dhe programet e studimit.....	58
Neni 57. Programet e ciklit të parë të studimeve.....	59
Neni 58. Pranimi në ciklin e parë të studimit.....	59
Neni 59. Programet e ciklit të dytë të studimeve.....	60
Neni 60. Pranimi në ciklin e dytë të studimit.....	61
Neni 61. Programet e ciklit të tretë të studimeve.....	62



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

Neni 62. Pranimi në ciklin e tretë të studimit.....	62
Neni 63. Cikli i tretë i studimeve.....	63
Neni 64. Programet e përbashkëta të studimit.....	63
Neni 65. Programet e studimeve të formimit të vazhduar.....	64
Neni 66. Ndjekja e një programi të dytë studimi.....	64
Neni 67. Viti akademik dhe organizimi i mësimdhënies	64
Neni 68. Vlerësimi.....	65
Neni 69. Transferimi i studimeve, njohja dhe njësimi i periudhave të studimit.....	65
Neni 70. Kohëzgjatja e studimeve.....	66
Neni 71. Lëshimi i diplomave, certifikatave dhe suplementi i diplomës.....	66

KREU VII

STUDENTËT..... 67

Neni 72. Fitimi, pezullimi dhe humbja e statutit të studentit.....	67
Neni 73. Të drejtat dhe detyrimet e studentëve.....	67
Neni 74. Këshillat e studentëve.....	68
Neni 75. Mbrojtësi i Studentëve.....	69
Neni 76. Karta e studentit.....	69
Neni 77. Koordinatori për marrëdhëniet me studentin.....	69
Neni 78. Dokumentacioni mësimor.....	70
Neni 79. Baza e të dhënave të studentëve.....	71

KREU VIII

SIGURIMI I CILËSISË..... 72

Neni 80. Sigurimi i brendshëm i cilësisë.....	72
Neni 81. Parimet e funksionimit të sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.....	72
Neni 82. Përbërja e Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë.....	72

KREU IX

KËRKIMI SHKENCOR..... 74

Neni 83. Kërkimi shkencor dhe zhvillimi në UV.....	74
Neni 84. Veprimtaritë kërkimore në UV.....	74
Neni 85. Planifikimi dhe vlerësimi i veprimtarive kërkimore.....	74

KREU X

AUTONOMIA FINANCIARE..... 75

Neni 86. Pronat dhe burimet e financimit.....	75
Neni 87. Hartimi, miratimi dhe zbatimi i buxhetit.....	75
Neni 88. Kontrolli i brendshëm.....	76
Neni 89. Pronat e UV-së.....	76
Neni 90. Vula, stema dhe rregullorja.....	76



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI “ISMAIL QEMALI” VLORE
SENATI AKADEMIK**

KREU XI

PROCEDURAT ZGJEDHORE.....	77
Neni 91. Procedura të zgjedhjeve në UV.....	77

KREU XII

DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT.....	77
Neni 92. Miratimi i rregulloreve.....	77
Neni 93. Shfuqizime.....	78
Neni 94. Hyrja në fuqi.....	78

ANEKSE.....	79
Organigrama e UV	81

Shkurtime

UV	Universiteti “Ismail Qemali”, Vlorë
MAS	Ministria e Arsimit dhe Sporteve
HEAL	Hapësira Evropiane e Arsimit të Lartë
SA	Senati Akademik
BA	Bordi i Administrimit
QKSH	Qendra Kërkimore-Shkencore
KSCBF	Komisionet e Sigurimit të Cilësisë së Brendshme të njësive kryesore
KSBCI	Komisioni i Sigurimit të Cilësisë së Brendshme në nivel institucional
KMSF	Komisionet e marrëdhënieve me studentët për çdo fakultet
KMSI	Komisionet e marrëdhënieve me studentët në nivel institucional
KDGDF	Komisioni i dhënies së gradës shkencore “Doktor” për çdo fakultet
IAL	Institucion i Arsimit të Lartë
ECTS	Kredite europiane
ASCAL	Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë
AKKSHI	Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI “ISMAIL QEMALI” VLORE

HYRJE

Universiteti “Ismael Qemali”, Vlorë është një prej institucioneve publike të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor në Republikën e Shqipërisë, i llojit universitet, me tradita, vlera dhe arritje arsimore e shkencore të konsoliduara ndër vite, të njohura dhe të vlerësuara brenda dhe jashtë vendit.

Ky Statut përmban një tërësi normash që rregullojnë veprimtarinë e institucionit në përputhje me legjislacionin në fuqi, në garantim të autonomisë universitare dhe lirisë akademike, të mbrojtura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, me synim zhvillimin e vazhdueshëm për të qenë të aftë në përballimin e sfidave të kohës.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE

KREU I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Personaliteti juridik

1. Universiteti "Ismail Qemali", Vlorë (në vijim me shkurtimin UV) është institucion publik i arsimit të lartë, i krijuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 105, datë 28. 02. 1994, bazuar në nenin 57, pika 7 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.
2. Universiteti "Ismail Qemali", Vlorë është *person juridik publik*, i njohur me ligj si i tillë, veprimtaria e të cilit bazohet në nenin 57, pika 7, në nenin 58 të Kushtetutës, në ligjin nr. 80/2015, datë 22. 07. 2015, "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", në parimet dhe standardet e Hapësirës Evropiane të Arsimit të Lartë (HEAL), në akte të tjera ligjore e nënligjore, në këtë Statut, si dhe në rregulloret dhe aktet e tjera të brendshme, të miratuara apo të dala në zbatim të tij, duke reflektuar parimet dhe objektivat e procesit të Bolonjës.
3. Universiteti "Ismail Qemali", Vlorë si *person juridik publik* merr pjesë në veprimtaritë publike e private dhe në qarkullimin civil, brenda ose jashtë vendit, në ushtrim të funksioneve dhe në realizim të qëllimeve të tij të ligjshme.
4. Selia qendrore e Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë ndodhet në godinën qendrore të Rektoratit, në adresën: Lagjja "Pavarësia", 9400, Vlorë, Shqipëri.
5. Stema dhe vula janë sipas anekseve bashkëlidhur.

Neni 2

Baza ligjore

1. Statuti i Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë hartohet në bazë të ligjit nr. 80/2015, datë 22. 07. 2015, "Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", si dhe në akte të tjera ligjore e nënligjore në fuqi. Ky Statut vepron mbi të gjitha njësitë përbërëse organizative të këtij universiteti.

Neni 3

Roli dhe misioni

1. Universiteti "Ismail Qemali", Vlorë ka si mision:
 - a. ofrimin e programeve të studimit në fusha të ndryshme në të tri ciklet e studimit të arsimit të lartë, si dhe programe studimi me karakter profesional, referuar niveleve 5, 6, 7, dhe 8 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve;
 - b. nxitjen e njohurive dhe shkencës përmes punës kërkimore-shkencore, punës akademike, aktivitetit krijues dhe bashkëpunimit me të tretët.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE SENATI AKADEMIK

2. Universiteti "Ismail Qemali", Vlorë e zhvillon veprimtarinë në këto drejtime:
 - a. mësimdhënie bashkëkohore, sipas të gjitha standardeve ndërkombëtare;
 - b. formim i specialistëve të lartë dhe përgatitje të shkencëtarëve të rinj, në përputhje me prioritetet e zhvillimit të vendit;
 - c. punë kërkimore-shkencore bazë dhe e aplikuar, si dhe veprimtari akademike të cilësisë së lartë;
 - d. shërbime me ndikim në publik dhe në komunitet, si dhe shërbime për zhvillimin ekonomik, social dhe kulturor, në nivel kombëtar dhe rajonal;
 - e. programe gjithëpërfshirëse aktiviteteve për aftësimin dhe zhvillimin e studentëve;
 - f. nxitje e bashkëpunimit ndërkombëtar në fushën e kërkimit shkencor dhe arsimit të lartë;
 - g. aktivitete ekonomik brenda kuadrit ligjor në fuqi.

Neni 4 Qëllimet

1. UV-ja ka për qëllim zhvillimin e arsimit, kulturës, shkencës dhe ekonomisë, në shërbim të lirisë e diversitetit të ideve, për ndërtimin dhe konsolidimin e shoqërisë demokratike dhe shtetit ligjor, për rritjen e mirëqenies dhe dinjitetit njerëzor, të realizuara me veprimtari të ligjshme e transparente.
2. UV-ja synon zhvillimin e veprimtarisë së saj brenda sistemit arsimor e të kërkimit shkencor kombëtar dhe ndërkombëtar, duke u angazhuar në organizma/veprimtari të përhershme/të përkohshme në fushën përkatëse, brenda ose jashtë vendit.
3. Universiteti "Ismail Qemali", Vlorë është një institucion publik i arsimit të lartë, personeli i të cilit ka për detyrim ligjor zhvillimin e procesit mësimor, transmetimin e dijeve, kërkimin bazë dhe të aplikuar, mbështetjen për institucionin, si dhe formimin edukativ, pedagogjik dhe shkencor të studentëve. UV-ja realizon projekte zhvillimi duke respektuar legjislacionin shqiptar, ndërkombëtar e në veçanti legjislacionin e BE-së dhe vendeve anëtare të OECD-së në këtë fushë. Organizimi dhe realizimi i të gjitha fazave të projekteve të zhvillimit respektojnë rigorozisht kuadrin ligjor procedural dhe financiar të lartpërmendur.
4. Universiteti "Ismail Qemali", Vlorë ushtron funksionet themelore të kërkimit shkencor dhe të didaktikës në çdo program studimi, përfshirë orientimin, formimin e përhershëm dhe përditësimin kulturor e profesional, veprimtaritë bazë apo plotësuese për to, si dhe kërkimin e aplikuar për problemet me interes publik apo privat.
5. Universiteti "Ismail Qemali", Vlorë garanton të drejtën e studimit sipas mundësive të barabarta, mbi bazën e meritës në të gjitha ciklet e studimit.
6. Universiteti "Ismail Qemali", Vlorë i ofron personelit akademik mundësi të barabarta për të përfituar nga financimi për kërkimin shkencor.
7. Universiteti "Ismail Qemali", Vlorë nxit ndërkombëtarizimin e të gjithë veprimtarisë së institucionit. Universiteti "Ismail Qemali", Vlorë konsideron si një nga detyrat e tij themelore zhvillimin e shkëmbimeve ndërkombëtare të personelit akademik dhe të studentëve, si dhe pranimin dhe formimin e studentëve të huaj.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË SENATI AKADEMIK

8. Universiteti "Ismail Qemali", Vlorë ndjek qëllimet e tij në përputhje të plotë me dinjitetin njerëzor, në pluralizmin e ideve dhe në transparencën e procedurave. Universiteti i garanton personelit akademik autonominë e kërkimit dhe lirinë akademike, sipas dispozitave të këtij Statuti, në përputhje me legjislacionin në fuqi, me të drejtën e studimit dhe pozitën juridike përkatëse.
9. Universiteti "Ismail Qemali", Vlorë lëshon diploma dhe jep tituj akademikë në përputhje me nivelin e kualifikimit dhe të aktivitetit kërkimor-shkencor. Universiteti ka të drejtën të lëshojë certifikata apo tituj për kurse trajnimi, studime kualifikimi dhe aktivitete të tjera, të miratuara paraprakisht nga autoritetet përkatëse, duke nxitur dhe ofruar aktivitete shkencore, shërbime kulturore dhe formuese.

Neni 5

Parimet e funksionimit

1. UV-ja përfshin në programet mësimore e studimore dhe garanton shprehjen e lirë të ideve shkencore, kulturore, politike, sindikale e fetare, duke mos lejuar hallka organizative e aktivitete të partive politike e komuniteteve fetare, përveç atyre me karakter shkencor e përkujtimor.
2. Traditat më të mira morale, kulturore, historike, arsimore dhe shkencore të vendit, të gërshtuara me standardet dhe arritjet më të mira botërore përgjithësisht, e ato evropiane në veçanti, janë baza e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor.
3. Personelit akademik të angazhuar me kohë të plotë ose të pjesshme në procesin e mësimdhënies apo kërkimit shkencor i garantohet autonomia dhe liria e veprimtarisë akademike në realizimin e programeve dhe objektivave të miratuara në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe dispozitat e këtij statuti.
4. Mundësia e barabartë për kushtet materiale, financim të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, është kriteri themelor në veprimtarinë akademike e kërkimore.
5. Mbështetja për diferencime individuale ose grupe është përjashtim që lejohet nga organi kompetent, në mënyrën e përcaktuar në ligj apo në akte nënligjore, për objektiva të një rëndësie të veçantë, për raste emergjente, për shkak të detyrimeve ndërkombëtare ose në mbështetje të talenteve.
6. UV-ja u krijon studentëve kushtet për përvetësimin e dijeve, shprehjen e lirë të mendimit e të organizimit në respektim të ligjit dhe të këtij statuti.
7. Universiteti "Ismail Qemali", Vlorë nxit dhe garanton diskutimin dhe shkëmbimin e mendimit të lirë për problemet që lidhen me përmbushjen e qëllimeve të tij. Universiteti garanton publikimin e akteve të nxjerra prej organeve të tij, me përjashtim të atyre që kanë karakter konfidencial.
8. Universiteti "Ismail Qemali", Vlorë nxit pjesëmarrjen në votime dhe fshehtësinë e votës në zgjedhjen e organeve të tij.
9. Senati Akademik i Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë analizon dhe vlerëson efikasitetin dhe mënyrën e hartimit, përdorimit dhe realizimit të buxhetit, performancën e strukturave



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE SENATI AKADEMIK

financiare e administrative në funksion të shërbimeve për studentët, personelin akademik e ndihmësakademik. Rektori, Senati Akademik dhe Asambleja e personelit akademik, së bashku apo më vete, brenda kompetencave të tyre, propozojnë/sugjerojnë alternativa veprimi në përmbushjen e detyrave përkatëse, me qëllim ekonomizimin dhe efikasitetin e drejtimit të universitetit. Për këtë qëllim Rektori dhe SA-ja në bashkëpunim me BA-në përpunojnë dhe shpallin treguesit, për të verifikuar objektivat e vendosura, rezultatet e arritura dhe kostot përkatëse.

10. Pasqyrat financiare të universitetit bëhen publike brenda 30 ditëve nga miratimi i organit përkatës.
11. Universiteti vendos lirisht për të kërkuar konsulencë nga profesionistë të çdo fushe.

Neni 6

Zhvillimi i veprimtarisë

1. Universiteti "Ismael Qemali", Vlorë ka zotësi të plotë juridike për të vepruar dhe përmbushur misionin, qëllimet dhe veprimtarinë institucionale sipas këtij statuti dhe legjislacionit në fuqi. UV-ja në veprimtarinë e saj gëzon të gjitha të drejtat e garantuara me ligj, lirinë akademike, autonominë financiare, autonominë organizative dhe të përzgjedhjes së personelit.
2. Universiteti "Ismael Qemali", Vlorë e zhvillon veprimtarinë e tij institucionale në mënyrë autonome sipas nenit 3 të ligjit nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë".
3. Universiteti "Ismael Qemali", Vlorë, në përputhje me objektivat e tij të politikës arsimore, të kërkimit shkencor, të mësimdhënies dhe në respektim të lirisë së secilit, harton programe dhe projekte specifike sipas nevojave të fushave të ndryshme. Universiteti konkurren në projekte kombëtare dhe ndërkombëtare dhe veçanërisht në projekte me ndikim për financimin e kërkimit shkencor, teknologjik dhe kulturor.
4. Universiteti "Ismael Qemali", Vlorë në mbështetje të veprimtarisë së tij, të aktivitetit dhe kërkimit shkencor, të nxitjes së vlerave, boton periodikisht revista shkencore, buletine shkencore, materiale të aktiviteteve të ndryshme shkencore, si dhe botime të tjera.
5. Veprimtaria e UV-së organizohet dhe realizohet nëpërmjet njësive përbërëse akademike, ndihmësakademike dhe administrative të shtrira në njësitë kryesore dhe në strukturën e Rektoratit. Veprimtaria e UV-së drejtohet e kontrollohet nga autoritetet dhe organet drejtuese të saj që veprojnë, sipas hierarkisë, me kompetenca të përcaktuara në ligjin e arsimit të lartë, në statut, në rregullore dhe në aktet e brendshme vetërregulluese të institucionit.
6. UV-ja në përputhje me objektivat e saj, të politikës kulturore, të kërkimit, të mësimdhënies dhe në respektimin e lirisë së secilit, harton programe dhe projekte specifike sipas nevojave të fushave të ndryshme. Konkurren me këto projekte në planin kombëtar për financimin e kërkimit shkencor, teknologjik dhe kulturor, si dhe në planin ndërkombëtar.
7. Përfundimi dhe vlerësimi i studimeve dhe kërkimeve shkencore bëhet nga organi përkatës sipas ligjit dhe akteve nënligjore me certifikata, diploma, dëshmi, tituj dhe grada shkencore,



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE SENATI AKADEMIK

përmbajtja dhe formatet e të cilave miratohen nga Senati Akademik, në përputhje me udhëzimet e organit kompetent sipas ligjt.

8. UV-ja vlerëson mënyrën e përdorimit të buxhetit të shpenzuar nga njësitë e saj në përmbushjen e detyrave përkatëse, me qëllim ekonomizimin dhe efikasitetin e drejtimit të Universitetit, si dhe përpunon e shpall indikatorët për të verifikuar objektivat e vendosura, rezultatet e arritura dhe kostot përkatëse.

Neni 7

Mbrojtja juridike

Të gjitha pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme që Universiti administron ligjërisht në përputhje me misionin e tij, gëzojnë paprekshmërinë e siguar nga ligji. Kjo paprekshmëri përfshin moslejimin e ndërhyrjes në mjediset e universitetit apo të përdorimit të tyre nga çdo person fizik e juridik, mosndërhyrjen e pushtetit qendror e vendor dhe të organeve të rendit publik pa kërkesën apo lejen nga Rektori i Universitetit ose personi i autorizuar prej tij. Vetëm në rastet e kryerjes së një krimi flagrant dhe në rastet e një fatkeqësie natyrore, organet e rendit publik ndërhyjnë dhe pa lejen e Rektorit.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE SENATI AKADEMIK

KREU II

STRUKTURA ORGANIZATIVE

Neni 8

Universiteti

1. Universiteti "Ismail Qemali", Vlorë është institucion publik i arsimit të lartë që përfaqëson një strukturë unike në të cilën janë të integruar 4 (katër) njësi kryesore (fakultete), si dhe struktura ndihmësakademike dhe administrative të Rektoratit.
2. Me propozim të Rektorit, Senati Akademik harton dhe miraton strukturën e përgjithshme dhe organikën (organigramën) e UV-së dhe i propozon BA-së numrin e përgjithshëm të personelit në të gjitha nivelet. Ndryshime të pjesshme të strukturës së përgjithshme dhe numrit të përgjithshëm të personelit, në të gjitha nivelet, hapje të njësive kryesore apo bazë, mund të kryhen konform procedurave dhe legjislacionit në fuqi. Struktura e plotë e UV-së, organika dhe organigrama e tij i bashkëlidhen këtij Statuti.

Neni 9

Njësitë kryesore

1. Fakulteti në UV është njësi kryesore që bashkërendon mësimdhënien dhe kërkimin shkencor në fusha të përafërta ose të ndërthurura.
2. Fakultetet organizohen nga së paku tri njësi bazë, ku dy duhet të jenë departamente. Në çdo fakultet funksionon edhe qendra kërkimore-shkencore.
3. Ndryshimi i numrit dhe emërimit të fakulteteve, QKSH-ve, departamenteve apo strukturave të tjera, në kuptimin e mbylljes apo hapjes (shtimit apo pakësimit) kryhet në bazë të procedurave të parashikuara në ligj.
4. UV-ja përbëhet nga këto njësi kryesore:
 - a) Fakulteti i Ekonomisë;
 - b) Fakulteti i Shkencave Humane;
 - c) Fakulteti i Shkencave Teknike dhe Natyrore;
 - d) Fakulteti i Shëndetit.
5. Fakultetet ofrojnë programe studimi të cikleve të ndryshme dhe miratojnë kriteret e pranimit të studentëve për secilin program studimi, sipas propozimeve të njësive bazë, në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe aktet nënligjore.
6. Fusha specifike e secilës njësi kryesore përcaktohet në rregulloren e universitetit.

Neni 10

Njësitë bazë

1. Departamenti është njësi bazë e zhvillimit të mësimdhënies dhe punës kërkimore shkencore të fakultetit, i cili përfshin fusha kërkimi të përafërta dhe grupon disiplinat mësimore respektive.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE SENATI AKADEMIK

2. Departamenti mund të organizohet në grupe mësimore dhe në grupe të përhershme ose të përkohshme kërkimore-shkencore të cilat përbëhen nga jo më pak se 5 anëtarë, personel akademik me kohë të plotë.
3. Departamenti duhet të ketë në përbërje së paku 7 anëtarë, personel akademik me kohë të plotë, ku së paku 3 prej tyre duhet të kenë grada shkencore/tituj akademikë, si dhe personel ndihmës akademik.
4. UV-ja përbëhet nga këto njësi bazë:
 - Fakulteti Shkencave Humane:
 - 1) Departamenti i Drejtësisë;
 - 2) Departamenti i Gjuhës Shqipe dhe Letërsisë;
 - 3) Departamenti i Edukimit;
 - 4) Departamenti i Gjuhëve të Huaja;
 - Fakulteti i Ekonomisë:
 - 1) Departamenti i Biznesit;
 - 2) Departamenti i Financës dhe Kontabilitetit;
 - 3) Departamenti i Ekonomiksit;
 - Fakulteti i Shëndetit:
 - 1) Departamenti i Infermierisë;
 - 2) Departamenti i Kujdesit Shëndetësor;
 - 3) Qendra kërkimore- shkencore e Shëndetit Publik;
 - Fakulteti i Shkencave Teknike dhe Natyrore:
 - 1) Departamenti i Inxhinierive dhe Teknologjisë Detare;
 - 2) Departamenti i Shkencave Detare;
 - 3) Departamenti i Biologjisë;
 - 4) Departamenti i Matematikës dhe Fizikës;
 - 5) Departamenti i Shkencave Kompjuterike;
 - 6) Departamenti i Kimisë.
5. Disiplinat mësimore, fushat e kërkimit shkencor dhe struktura organizative e secilit departament përcaktohen në rregulloren e universitetit.
6. Departamenti propozon programet e studimit, si dhe numrin e studentëve për çdo program në përputhje me kapacitetin akademik dhe infrastrukturor.
7. Departamenti propozon kriteret e pranimit të studentëve për çdo program studimi dhe përzgjedh studentët fitues të cilët miratohen nga dekani i fakultetit sipas procedurave të përcaktuara në rregulloren e universitetit.
8. Departamenti diskuton dhe vendos për çdo çështje që lidhet me programet e studimit: programet mësimore, planet kalendarike, ligjëratat e disiplinave dhe moduleve, platformat e seminareve, literaturën, ciklet e leksioneve, tekstet mësimore etj. Departamenti arkivon kopjet origjinale/fotokopje të këtij dokumentacioni mësimor i cili vihet në dispozicion të autoriteteve drejtuese në rast kontrolli apo verifikimi (të brendshëm apo të jashtëm) të elementeve që lidhen me to.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE SENATI AKADEMIK

9. Departamenti, pasi merr paraprakisht miratimin e dekanit dhe të rektorit, vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucione dhe organizata, në rastet kur fusha e bashkëpunimit shtrihet vetëm në juridiksionin e departamentit.
10. Departamenti mund të ofrojë shërbime për të tretë, si dhe të zhvillojë veprimtari të tjera. Ato përcaktohen në rregulloren e departamentit, në përputhje me këtë statut e legjislacionin në fuqi.
11. Departamenti e bazon veprimtarinë e tij në rregulloren e brendshme. Rregullorja miratohet nga Senati Akademik.

Neni 11

Qendrat kërkimore-shkencore

1. Fakultetet e UV-së kanë në përbërjen e tyre edhe qendra kërkimore-shkencore. Ato miratohen nga Senati Akademik, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi dhe kryejnë veprimtari kërkimore-shkencore dhe zhvillimi.
2. Në UV funksionojnë këto qendra kërkimore-shkencore:
 - 1) Qendra kërkimore - shkencore në Shkencat e Aplikuara;
 - 2) Qendra kërkimore - shkencore për Inovacion dhe Teknologji;
 - 3) Qendra kërkimore - shkencore e Shëndetit Publik;
 - 4) Qendra kërkimore - shkencore e Albanologjisë dhe Ballkanistikës.
3. Qendrat kërkimore-shkencore kanë në përbërjen e tyre, në çdo rast një përgjegjës (personel akademik), personel akademik si dhe personel ndihmës akademik.
4. Kur plotësojnë standardet (kushtet dhe kriteret) e njësisë bazë, ato llogariten për qëllimin e përmbushjes së standardeve institucionale. Qendra kërkimore- shkencore nëse do të jetë pjesë e strukturës së njësisë kryesore për plotësimin e standardeve të kësaj njësie, duhet të përbëhet nga të paktën 7 anëtarë, nga të cilët, të paktën 3 të jenë me grada shkencore ose tituj. Drejtuesi zgjidhet sipas rregullave të zgjedhjes së drejtuesit të njësisë bazë.
5. Qendrat kërkimore-shkencore mund të mbështetin realizimin e programeve të studimit "Master i shkencave" dhe "Doktoratë" të ofruara nga departamentet e fakultetit ose departamentet e fakulteteve të tjera.
6. Përbërja, funksionimi dhe drejtimi më i detajuar i QKSH-ve të fakulteteve përcaktohen në aktet e tjera të brendshme të institucionit, në rregulloret e organizimit dhe funksionimit të tyre të miratuara në dekanatet e fakulteteve dhe në SA.

Neni 12

Qendra studimore ndërdisiplinore

1. Qendra studimore ndërdisiplinore është qendër e studimeve ndërdisiplinore për zhvillim rajonal duke pasur si synim kryesor të zhvillojë aktivitete të misionit të tretë në Universitetin "Ismael Qemali", Vlorë.
2. Qendra ka në misionin e saj aktivitete multi-funksionale të orientuara në këto drejtime kryesore:



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE SENATI AKADEMIK

- a. Organizim, menaxhim dhe zhvillim i aktiviteteve të edukimit dhe trajnimit të vazhdueshëm për studentët, alumni, akademikët dhe profesionistë, komunitetin e gjerë.
- b. Mbështetje dhe zhvillim të punës kërkimore dhe shkencore në fusha ndërdisiplinore duke zhvilluar konferenca, seminare dhe workshop-e, me qëllim analizën dhe gjetjen e problematikave duke ofruar zgjidhje akademike inovative.
- c. Zhvillim i projekteve ndërdisiplinore me partner kombëtar dhe ndërkombëtar, me qendra homologe dhe institucione të arsimit të lartë, me qëllim mbështetje për zhvillimin e institucionit dhe stafit duke forcuar rolin aktiv të tij në rajon.
- d. Studim i metodologjive dhe modeleve të reja nëpërmjet organizimit të takimeve dhe eventeve me objektiva të caktuara me qëllim forcimin e bashkëpunimit të departamenteve dhe fakulteteve për nxitjen e iniciativave në zhvillimin e kurrikulave të karakterit ndërdisiplinor.
- e. Promovim i inovacioneve dhe përçimin i gjetjeve dhe zgjidhjeve akademike tek bizneset dhe institucionet e tjera në rajonin e Vlorës.
- f. Rritje e numrit të të punësuarve dhe aftësive profesionale të të diplomuarve në universitet, bazuar në një studim periodik të tregut të punës në bashkëpunim me mekanizma shtetërore informuese.
- g. Vendosje dhe stabilizim i një sistemi cilësor të edukimit të vazhdueshëm për universitetin, bazuar në zhvillimin e një sistemi informacioni të qëndrueshëm dhe interaktiv.

Neni 13

Struktura e brendshme e UV

I – Strukturat e brendshme akademike dhe administrative të Universitetit 'Ismael Qemali' organizohen si vijon:

Struktura Akademike në nivel institucioni

- Senati Akademik
- Rektorati
- Rektori
- Zv.Rektori Akademik
- Zv.Rektori për Marrëdhëniet me Jashtë dhe Kërkimin Shkencor

Struktura ndihmës akademike me karakter administrativ në nivel institucioni

- Asistenti i Rektorit
- Drejtorja e Shërbimeve ndihmës-akademike
 - 1) Sektori i kurrikulave dhe statistikave
 - 2) Sektori i sigurimit të brendshëm të cilësisë dhe akreditimit
 - 3) Sektori i burimeve njerëzore dhe arkiv-protokollit
 - 4) Sektori juridik
 - 5) Sektori i IT
 - 6) Sektori i bibliotekës dhe botimeve



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË SENATI AKADEMIK

- Drejtoria e Kërkim-Zhvillimit dhe Marrdhënieve me të tretët
 - 1) Sektori i kërkimit shkencor dhe projekteve
 - 2) Sektori i marrdhënieve me jashtë
 - 3) Sektori i promovimit dhe marrëdhënieve me publikun
 - 4) Sektori i karrierës, shërbimit të studentëve dhe alumni
 - 5) Qendra e Zhvillimit Rajonal

Struktura Administrative në nivel institucioni

- Bordi i Administrimit
- Administratori
- Sektori i auditimit të brendshëm
- Drejtoria e Shërbimeve administrative
 - 1) Sektori ekonomik
 - 2) Sektori i prokurimeve dhe investimeve
 - 3) Sektori i shërbimeve

Struktura Akademike në nivel njësie kryesore

1. Asambleja e Personelit Akademik
2. Dekanati
3. Dekan
4. Zv.dekan akademik
5. Zv.dekan për kërkimin shkencor

Struktura ndihmës akademike me karakter administrativ në nivel njësie kryesore

1. Sekretaria mësimore
2. Asistenti i Dekanit / Specialist i Arkiv-Protokollit
3. Sektori i Shërbimeve Ndihmës/akademike
 - a. Specialisti i bibliotekës
 - b. Specialisti IT
 - c. Specialist i zyrës së studentëve

Struktura administrative në nivel njësie kryesore

1. Sektori i Shërbimeve Administrative
 - a. Specialist finance
 - b. Shërbime: mirëmbajtës, punonjës pastrimi.

Struktura ndihmës akademike me karakter akademik në nivel njësie bazë

1. Laborant

Struktura ndihmës akademike me karakter akademik në nivel Qendre kërkimore/shkencore

1. Specialist
2. Laborant



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI “ISMAIL QEMALI” VLORE SENATI AKADEMIK

- II - Varësia e strukturës së brendshme të Universitetit ‘Ismail Qemali’ është si më poshtë vijon:
- Strukturat akademike, ndihmësakademike me karakter mësimor dhe ndihmësakademike me karakter administrativ janë në varësi të Rektorit.
 - Strukturat akademike dhe ndihmësakademike me karakter mësimor e administrativ në nivel njësie kryesore kanë varësi funksionale nga Dekani i njësisë kryesore përkatëse.
 - Strukturat akademike, ndihmësakademike me karakter mësimor, në nivel njësie bazë kanë varësi funksionale nga Drejtuesi i njësisë bazë përkatëse.
 - Strukturat administrative në nivel institucioni janë në varësi të Administratorit të UV.
 - Strukturat administrative në nivel njësie kryesore, në mungesë të Administratorëve të Fakulteteve, mbeten në varësi të Administratorit të Institucionit.
 - Struktura e Auditit të Brendshëm është në varësi të Bordit të Administrimit.
 - Strukturat juridike, burimeve njerëzore, arkiv-protokollit dhe teknologjisë së informacionit në nivel institucioni apo njësie kryesore, ushtojnë veprimtarinë e tyre në funksion të të gjitha strukturave në institucion.

III - Kjo hierarki organizative paraqitet skematikisht në Organigramën e Universitetit ‘Ismail Qemali’.

Neni 14 Degët

- Universiteti “Ismail Qemali”, Vlorë ka të drejtë që, në përputhje me qëllimet e veta, të hapë degë të tij në qytete të tjera të Shqipërisë, të cilat mund të jenë njësi kryesore ose njësi bazë si struktura të veçanta, por edhe si pjesë përbërëse të njësive të selisë qendrore.
- Dega ofron programe studimi sipas fushave përkatëse, të cilat u nënshtrohen procedurave dhe kriterëve të akreditimit sipas përcaktimeve ligjore dhe nënligjore.



KREU III ORGANET DREJTUESE

Neni 15 Organet kolegjiale dhe autoritetet drejtuese

1. Organi më i lartë drejtues akademik i universitetit është Senati Akademik.
2. Organe të tjera akademike janë asambleja e personelit akademik dhe komisionet e përhershme.
3. Autoritetet drejtuese akademike janë: rektori, dekani dhe drejtuesi i njësisë bazë.
4. Organi më i lartë drejtues administrativ është Bordi i Administrimit.
5. Autoritetet drejtuese administrative janë administratori i institucionit dhe administratori i njësisë kryesore.
6. Organe të tjera kolegjiale janë: Rektorati, Dekanati dhe Këshilli i Etikës.
7. Anëtarët e Senatit Akademik dhe autoritetet drejtuese akademike zgjidhen nëpërmjet një procesi të përgjithshëm zgjedhor, i cili zhvillohet një herë në çdo katër vjet. Anëtarët e Bordit të Administrimit zgjidhen sipas përcaktimeve të ligjit për arsimin e lartë. Autoritetet drejtuese administrative përzgjidhen dhe shkarkohen sipas përcaktimeve të këtij statuti dhe legjislacionit në fuqi.
8. Anëtarët e Senatit Akademik, Bordit të Administrimit dhe anëtarët e komisioneve të përhershme shpërblehen financiarisht në përputhje me punën e kryer. Shpërblimi miratohet nga Bordi i Administrimit, bazuar në mundësitë financiare të universitetit dhe kuadrit ligjor në fuqi.

Neni 16 Rregulla të përgjithshme

1. Mbledhjet e organeve drejtuese zhvillohen të paktën një herë në muaj përgjatë vitit akademik.
2. Rendi i ditës propozohet nga drejtuesi dhe miratohet në çdo rast nga anëtarët e organit kolegjial.
3. Organi mund të mbledhet edhe në raste të jashtëzakonshme me një rend të caktuar, me nismën e drejtuesit ose me kërkesë me shkrim nga një e treta e të gjithë anëtarëve, përveç rasteve kur kërkohet shumicë e cilësuar.
4. Mbledhjet zhvillohen kur janë të pranishëm më shumë se gjysma e anëtarëve dhe drejtohen nga drejtuesi. Në raste të veçanta, drejtuesi i delegon të drejtën e drejtimit të mbledhjes së zakonshme një anëtar tjetër.
5. Vendimet merren me shumicën e thjeshtë të votave të anëtarëve të pranishëm në mbledhje, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe.
6. Votimi është i hapur. Votimi i fshehtë zbatohet në rastin e votimeve nominale dhe kur kërkohet nga shumica e thjeshtë e anëtarëve të pranishëm në mbledhje.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI “ISMAIL QEMALI” VLORE
SENATI AKADEMIK**

7. Çdo anëtar e ushtron vetë të drejtën e votës dhe nuk ka të drejtë ta delegojë atë.
8. Mbledhjet janë të hapura, pa të drejtë ndërhyrje nga të tretë. Me vendim të shumicës së anëtarëve të pranishëm, mund të ftohen persona të jashtëm për konsultim.
9. Vendimi bëhet publik brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike.
10. Procesverbalet e mbledhjeve bëhen publike vetëm me vendim të organit. Përmbajtja e procesverbalit përcaktohet në rregulloren e funksionimit të organit.

**Neni 17
Senati Akademik**

1. Senati është organi kolegjal më i lartë akademik i UV-së, përgjegjës për përmbushjen e misionit të tij.
2. Senati kryesohet nga Rektori dhe mbledhet periodikisht, por jo më pak se një herë në muaj.
3. Numri i anëtarëve të Senatit Akademik të UV-së është 23, duke përfshirë dhe Rektoren e UV-së. Anëtarët e Senatit Akademik të Universitetit “Ismael Qemali”, Vlorë zgjidhen me përfaqësim të barabartë në nivel njësie kryesore sipas përbërjes:
 - Rektori, (1 anëtar senati)
 - Dekanët, (4 anëtarë senati)
 - nga 4 pedagogë me kohë të plotë për secilin fakultet (16 anëtarë senati)
 - përfaqësues të studentëve në masën 10% (2 anëtarë senati).
4. Anëtarët e Senatit Akademik të UV-së zgjidhen me shumicë votash, nga asambltetë e personelit akademik të njërive kryesore përkatëse, përmes një votimi të përgjithshëm. Ata zgjidhen për një mandat katërvjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje, midis anëtarëve të personelit akademik me kohë të plotë, të vetëkandiduar.
5. Anëtarët e Senatit Akademik i përkasin kategorisë “Profesor” ose kanë gradën shkencore “Doktor” (PhD), të fituar në universitete të vendeve anëtare të OECD-së ose BE-së. Në mungesë të personelit akademik me këtë titull dhe, për efekt të përfaqësimit, kategoria e tyre mund të zbresë dhe të përzgjidhen si anëtarë të senatit edhe personel akademik që mban gradën shkencore “Doktor”.
6. Anëtarët e Senatit Akademik, përfaqësues të studentëve zgjidhen nga studentët në masën 10 përqind në përputhje me rregulloren e zgjedhjeve.
7. Senati kryesohet nga Rektori dhe mbledhet periodikisht, por jo më pak se një herë në muaj.
8. Senati Akademik zgjedh, në mbledhjen e tij të parë e me propozim të Rektorit, nënkryetarin dhe sekretarin e senatit. Kryetari, Nënkyetari dhe Sekretari përbëjnë Kryesinë e Senatit Akademik. Kryesia e Senatit Akademik kujdeset për mbarëvajtjen dhe funksionimin normal të Senatit Akademik.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK**

Neni 18

Mbarimi i mandatit të anëtarit të Senatit Akademik

1. Mandati i anëtarit të Senatit Akademik mbaron:
 - a) me mbarimin e afatit;
 - b) jep dorëheqjen;
 - c) largohet nga UV-ja; kur ndërpret marrëdhëniet e punës me UV-në;
 - d) bëhet i pamundur nga ana fizike apo mendore të ushtrijë funksionin;
 - e) nuk merr pjesë për 3 (tri) herë radhazi, pa shkaqe të arsyeshme në mbledhjet e Senatit Akademik;
 - f) dënohet me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një krimi;
 - g) mbush moshën e pensionit;
 - h) nuk jeton më.
2. Në rast se vendi mbetet vakant në Senatin Akademik, plotësimi i këtij vendi, duhet të bëhet nga kandidati pasardhës në renditje duke u marrë emri nga lista e kandidatëve të zgjedhjeve të fundit.

Neni 19

Funksionet e Senatit Akademik

1. Funksionet e Senatit Akademik janë:
 - a. garanton autonominë e UV-së, lirinë akademike, si dhe të drejtat e studentëve;
 - b. miraton dhe i dërgon për miratim Bordit të Administrimit planin strategjik të zhvillimit të universitetit;
 - c. miraton statutin e UV-së me 2/3 e votave të anëtarëve të tij, pasi të jetë marrë miratimi paraprak i Bordit të Administrimit;
 - d. harton strukturën e përgjithshme të UV-së dhe i propozon Bordit të Administrimit numrin e personelit të institucionit në të gjitha nivelet;
 - e. miraton paraprakisht dhe i dërgon për miratim Bordit të Administrimit buxhetin vjetor dhe atë afatmesëm të UV-së;
 - f. miraton rregulloret e institucionit, përveç atyre që janë kompetencë e Bordit të Administrimit;
 - g. i propozon BA-së pagesën e padagogëve për mbingarkesën mësimore;
 - h. miraton programet e reja të studimit, të kërkimit shkencor, ndryshimet, si dhe mbylljen e tyre. Programet e reja të studimit duhet të jenë të mbështetura në projektbuxhetin vjetor të institucionit;
 - i. miraton numrin e studentëve për çdo program studimi;
 - j. miraton kriteret e pranimit të studentëve për secilin program studimi;
 - k. miraton hapjen, riorganizimin ose mbylljen e njësive të UV-së mbi bazën e propozimeve të njësive kryesore dhe të njësive bazë, pas vlerësimit paraprak të Bordit të Administrimit;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
SENATI AKADEMIK

- l. miraton planin vjetor të veprimtarive akademike dhe veprimtarive kërkimore-shkencore;
- m. miraton raportin e detajuar vjetor të veprimtarisë së universitetit, të hartuar nga rektorati, dhe ia përcjell atë ministrisë përgjegjëse për arsimin;
- n. i paraqet kërkesë ministrisë përgjegjëse për arsimin, për vlerësimin e jashtëm të cilësisë dhe akreditimin e programeve të studimit apo vetë universitetit;
- o. i propozon ministrisë përgjegjëse për arsimin hapjen, mbylljen, ndryshimin dhe emërtimin e njësive kryesore dhe të programeve të studimit;
- p. propozon mbylljen dhe riorganizimin e institucionit, si dhe ndarjen ose bashkimin e institucionit me një institucion tjetër të arsimit të lartë;
- q. zgjedh përfaqësuesit e tij në Bordin e Administrimit të UV-së;
- r. garanton sigurimin e brendshëm të cilësisë në UV;
- s. garanton realizimin e objektivit për një universitet të bazuar në kërkimin shkencor, si dhe krijon mekanizmat për vlerësimin e veprimtarisë mësimore dhe kërkimore-shkencore të personelit akademik;
- t. krijon Komisionin e Përhershëm për Promovimin e Personelit Akademik, për dhënien e titujve akademikë "Profesor i asociuar" dhe "Profesor" apo edhe komisionet e tjera, në nivel qendror të institucionit, që mund të propozohen në përputhje me dinamikën e zhvillimit të UV-së;
- u. organizon mbledhjen e përbashkët, në bashkëpunim me Bordin e Administrimit, në fund të çdo viti akademik, ku diskutohet për veprimtarinë e mësimdhënies, kërkimin shkencor dhe atë financiare;
- v. shqyrton dhe miraton propozimet e njësive bazë, njësive kryesore dhe Komisionit të Promovimit të Personelit Akademik për dhënien e titujve "Doctor Honoris Causa" personaliteteve të shkencës, artit, kulturës, politikës dhe ekonomisë, vendas dhe të huaj;
- w. akordon, në vlerësim të veprimtarisë së spikatur akademike, titullin "Profesor emeritus" për anëtarë të personelit akademik të universitetit që mbajnë titullin "Profesor", pas daljes në pension, me propozim të njësisë bazë ku kanë zhvilluar karrierën;
- x. përcakton drejtimit kryesore të bashkëveprimeve të universitetit dhe njësive kryesore të tij me të tretët;
- y. miraton pranimin e donacioneve vendase apo të huaja, sipas akteve ligjore e nënligjore në fuqi, pas shqyrtimit të Bordit të Administrimit;
- z. vendos kriteret për shpërndarjen e bursave në fakultete, si dhe përcakton kriteret e shpërblimit për studentët e shkëlqyer të universitetit;
- aa. përcakton kriteret e shpërblimit për personelin akademik që është shquar në realizimin e një detyrë të caktuar të një rëndësie të veçantë;
- bb. thërret administratorin e UV-së për të raportuar për veprimtarinë e tij, të paktën dy herë në vit;
- cc. shpreh vullnetin e tij me vendime të cilat kanë fuqi të drejtpërdrejtë.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË SENATI AKADEMIK

2. Modalite të tjera të ushtrimit të funksioneve të Senatit Akademik do të bëhen në akte të tjera të brendshme të UV-së.
3. Senati Akademik publikon të gjitha vendimet e marra prej tij konform përcaktimeve të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008, "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar dhe ligjit nr.119/2014, datë 18.09.2014, "Për të drejtën e informimit".

Neni 20

Bordi Konsultativ

1. Bordi Konsultativ është organ kolegjal, i cili ka si qëllim të konsultojë Senatin Akademik dhe Rektorin e Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë për implementimin dhe zbatimin e politikave sa më efikase universitare dhe eksperiencave më të mira perëndimore.
2. Bordi ndihmon dhe jep kontributin e tij me qëllim rritjen e bashkëpunimit ndërkombëtar të Universitetit në aktivitetet e tij akademike, trajnuese dhe kërkimore, si dhe në hartimin dhe implementimin e strategjisë së tij. Bordi Konsultativ ushtron veprimtarinë e tij në çështje që lidhen me prioritetet dhe orientimin drejt së ardhmes së Universitetit. Bordi nuk përfshihet në veprimtari administrative dhe vendimmarrje.
3. Anëtarët e Bordit janë personalitete të shquar të huaj ose shqiptarë, me arsimim dhe punësim në organizma prestigjioz, të spikatur në fushën e arsimit dhe shkencës.
4. Funksionet e Bordit Konsultativ përcaktohen në rregulloren e Universitetit.

Neni 21

Asambleja e personelit akademik

1. Asambleja e personelit akademik përbëhet nga personeli akademik me kohë të plotë i njësive kryesore.
2. Asambleja e personelit akademik të njësisë kryesore ka këto funksione:
 - a. zgjedh Rektorin e institucionit në institucionet publike të arsimit të lartë;
 - b. gjedh anëtarët e Senatit Akademik në institucionet publike të arsimit të lartë;
 - c. gjedh drejtuesin e njësisë kryesore në institucionet publike të arsimit të lartë;
 - d. krijon komisionet e përhershme të njësisë kryesore dhe zgjedh anëtarët e tyre.

Neni 22

Komisionet e përhershme

1. Komisionet e përhershme janë organe kolegjinale, të krijuara në nivel institucional dhe në nivel të njësive kryesore, që kryejnë funksione në fushat e përcaktuara në statut, që lidhen kryesisht me kualifikimin shkencor dhe promovimin akademik, garantimin e standardeve të cilësisë të institucionit dhe programeve të studimit, si dhe me mbarëvajtjen e veprimtarisë së tij dhe marrëdhëniet me studentët, në përputhje me misionin dhe politikat e institucionit.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI “ISMAIL QEMALI” VLORE
SENATI AKADEMIK**

2. Në Universitetin “Ismail Qemali” Vlorë ngrihen dhe ushtrojnë veprimtarinë e tyre këto Komisione të Përhershme:

- 1) Komisioni i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në nivel institucioni (KSBCI);
- 2) Komisioni i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për çdo njësi kryesore (KSBCF);
- 3) Komisioni i Marrëdhënieve me Studentët në nivel institucional (KSAKKI)
- 4) Komisioni i Marrëdhënieve me Studentët në nivel njësie kryesore (KSAKKF)
- 5) Komisioni i Dhënies së Gradës Shkencore “Doktor” për çdo njësi kryesore (KDGDF);
- 6) Komisioni i Promovimit të Personelit Akademik.

3. Komisionet e përhershme në nivel institucional në UV janë:

a) *Komisioni i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në nivel institucioni (KSBCI).*

Ky komision përbëhet nga 5 (pesë) anëtarë, nga të cilët 4 (katër) janë anëtarë nga personeli akademik i UV-së (nga një anëtar për çdo fakultet) që i përkasin kategorisë “Profesor” ose/dhe “Lektor” dhe 1 (një) anëtar është përfaqësues i studentëve.

Funksionet e këtij komisioni lidhen me garantimin e standardeve shtetërore të cilësisë si dhe në Standardet dhe Udhëzimet Europiane për Sigurimin e Cilësisë në Hapësirën Europiane të Arsimit të Lartë (HEAL). Komisioni ushtron kryesisht këto funksione:

- i. Harton politikat dhe planin e zhvillimit institucional për sigurimin e brendshëm të cilësisë dhe e dërgon për miratim në Senatin Akademik;
- ii. Harton Rregulloren e Sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në UV dhe e dërgon për miratim në Senatin Akademik;
- iii. Vlerëson në mënyrë periodike përmbushjen e standardeve shtetërore të cilësisë në nivel institucioni si dhe raporton përpara Senatin Akademik për rezultatet e vlerësimit.
- iv. Harton propozime në lidhje me përmirësimin e performancës së institucionit në përmbushje të standardeve shtetërore të cilësisë në nivel institucioni si dhe e dërgon për miratim në Senatin Akademik;
- v. Harton rekomandime në bashkëpunim me KSBCF në mbështetje të rezultateve të nxjerr prej instrumentave të ndryshëm që NJSBCVI/njësia kryesore përdor për sigurimin e cilësisë, si dhe i përcjell për miratim në Senatin Akademik;
- vi. Vlerëson në mënyrë periodike instrumentat ekzistues për sigurimin e brendshëm të cilësisë dhe propozon përmirësimet e nevojshme sipas rastit;
- vii. Harton raportin e vetëvlerësimit në kuadër të akreditimit institucional, si pjesë përbërëse e GVB-së që ngrihet prej institucionit për këtë qëllim;
- viii. Propozon pranë SA-së planin e veprimit në përmbushje të rekomandimeve të Bordit të Akreditimit në kuadër të akreditimit institucional si dhe monitoron zbatimin e tij;
- ix. Bashkëpunon me struktura të tjera në nivel institucioni si dhe bashkëpunorë të jashtëm për organizimin e aktiviteteve në përmbushje të standardeve kombëtare dhe ndërkombëtare të sigurimit të cilësisë;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
SENATI AKADEMIK

- x. Brenda muajit dhjetor të çdo viti kalendarik, harton dhe publikon raportin vjetor të veprimtarisë së tij me gjetjet dhe rekomandimet për përmirësimin e cilësisë së shërbimeve akademik dhe administrative.
- xi. Kryen çdo funksion tjetër të ngarkuar nga autoritetet dhe organet drejtuese të UV-s në fushën e sigurimit të cilësisë.

Gjatë ushtrimit të veprimtarisë së saj KSBCI mbështetet dhe bashkërendon punën me strukturat/organet e tjera në nivel njësie kryesore/nivel institucioni të ngritura me qëllim sigurimin e brendshëm të cilësisë.

b) *Komisioni i Marrëdhënieve me Studentët në nivel institucional (KMSI).*

Ky komision përbëhet nga 5 (pesë) anëtarë, nga të cilët 4 (katër) janë anëtarë nga personeli akademik i UV-së (nga një anëtar për çdo fakultet), që i përkasin kategorisë "Profesor" ose/dhe "Lektor" dhe 1 (një) anëtar është përfaqësues i studentëve.

Funksionet kryesore të këtij komisioni lidhen me garantimin e standardeve të marrëdhënieve të institucionit me studentët, alumni dhe këshillimin e karrierës. KMSI i kushton një vëmendje të veçantë marrëdhënieve të institucionit me studentët, shërbimeve ndihmës akademike dhe administrative ndaj tyre, si dhe marrëdhënieve të tyre me personelin, strukturat, autoritetet/organet drejtuese të institucionit. Komisioni ushtron kryesisht këto funksione:

- i. Harton politikat për mbrojtjen dhe mbështetjen e studentëve dhe i dërgon për miratim në Senatin Akademik;
- ii. Bashkëpunon me struktura të tjera në nivel institucioni si dhe bashkëpunorë të jashtëm për mbështetjen e studentëve;
- iii. Bashkëpunon me Këshillat Studentorë dhe koordinon punën me ta;
- iv. Propozon rekomandime për përmirësimin e cilësisë së shërbimeve të ofruara studentëve prej stafit administrativ dhe ndihmës-akademik në bazë të analizës së rezultateve të dalë nga instrumentat e ndryshëm që përdoren prej institucionit për këtë qëllim.
- v. Në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse, realizon periodikisht studime gjurmuese për të vlerësuar ecurinë e punësimit të studentëve dhe efikasitetin e programeve të ofruara nga Universiteti "Ismail Qemali", Vlorë.
- vi. Monitoron përfshirjen e studentëve në instrumentat që institucioni përdor për sigurimin e cilësisë dhe propozon masat e nevojshme për rritje të angazhimit të tyre.
- vii. Gjatë ushtrimit të veprimtarisë së saj KMSI mbështetet nga strukturat e tjera të ngritura me qëllim marrëdhëniet me studentët;
- viii. Në bashkëpunim me njësitë përkatëse në Rektorat organizon aktivitete të ndryshme me fokus studentët;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK**

- ix. Brenda muajit shtator të çdo viti kalendarik, harton dhe publikon raportin vjetor të veprimtarisë së tij me gjetjet dhe rekomandimet për garantimin e standardeve të marrëdhënieve të institucionit me studentët;
- x. Kryen çdo funksion tjetër të ngarkuar nga autoritetet dhe organet drejtuese të UV-s në fushën e marrëdhënieve me studentët.

Gjatë ushtrimit të veprimtarisë së saj KMSI mbështetet nga strukturat/ organet e tjera në nivel njësie kryesore/nivel institucioni të ngritura me qëllim garantimin dhe zhvillimin e marrëdhënieve të bashkëpunimit midis organeve drejtuese të UV-së dhe të studentëve dhe/apo organizmave studentorë.

c) Komisioni i Promovimit të Personelit Akademik.

Ky komision përbëhet nga 5 (pesë) anëtarë personel akademik i UV-së, që mbajnë titullin "Profesor" (nga një anëtar për çdo fakultet dhe një anëtar përfaqësues i Rektoratit).

Komisioni i Promovimit të Personelit Akademik ka një rol të rëndësishëm në menaxhimin dhe zhvillimin e karrierave akademike, duke siguruar që promovimi i personelit të jetë i drejtë, i bazuar në merita dhe të përputhshëm me politikat dhe rregulloret e institucionit arsimor. Funksionet e tij kryesore janë:

- i. Vlerësimi i kandidaturave për promovim:
 - a. Komisioni shqyrton dhe vlerëson kërkesat e personelit akademik për promovim në nivele të ndryshme të karrierës.
 - b. Ky vlerësim bazohet në kritere të tilla si arritjet akademike, hulumtimet shkencore, publikimet, kontributet në mësimdhënie dhe angazhimi në aktivitete profesionale dhe shoqërore.
- ii. Krijimi dhe përditësimi i kritereve të promovimit:
 - a. Komisioni ka përgjegjësinë për hartimin dhe përditësimin e kritereve dhe rregulloreve për promovimin e personelit akademik, duke i përshtatur ato me standardet akademike dhe kërkesat e zhvillimit të shkencës dhe mësimdhënies.
 - b. Siguron që kriteret për promovim të jenë të qarta, të drejtë dhe të bazuara në merita.
- iii. Përgatitja e rekomandimeve për promovim:
 - a. Komisioni përgatit dhe paraqet rekomandimet për promovimin e personelit akademik bazuar në vlerësimet e tyre individuale, duke siguruar që procesi të jetë objektiv dhe transparent.
 - b. Ky proces mund të përfshijë grumbullimin e informacionit nga disa burime, siç janë vlerësimet nga kolegët, rezultatet e kërkimeve dhe aktivitetet profesionale.
- iv. Përfaqësimi i interesave të personelit akademik:



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI “ISMAIL QEMALI” VLORE
SENATI AKADEMIK

- a. Komisioni ndihmon në përfaqësimin e interesave të personelit akademik gjatë procesit të promovimit, duke siguruar që ata të trajtohen në mënyrë të drejtë dhe të kenë mundësinë të avancojnë në karrierën e tyre akademike.
- v. Mbikëqyrja e procedurave të promovimit:
 - a. Komisioni mbikëqyr dhe siguron që të gjitha procedurat e promovimit të jenë të përmbushura në përputhje me rregulloret dhe politikat akademike të institucionit.
 - b. Siguron që procesi të jetë i qartë dhe i arritshëm për të gjithë kandidatët dhe të mos ketë preferenca apo diskriminime të padrejta.
- vi. Përgatitja e dokumentacionit dhe raportimeve:
 - a. Komisioni është përgjegjës për mbajtjen e dokumentacionit të plotë dhe të rregullt për çdo rast promovimi.
 - b. Ai gjithashtu mund të përgatisë raporte për administratën e lartë të institucionit mbi procesin e promovimit dhe përparimin e personelit akademik.
- vii. Mbështetje dhe këshillim për personelin akademik:
 - a. Komisioni mund të ofrojë mbështetje dhe këshilla për personelin akademik në lidhje me kriteret e promovimit dhe mundësitë për avancimin në karrierën akademike.
 - b. Ai mund të ofrojë rekomandime për zhvillimin e aftësive profesionale dhe shkencore që mund të kontribuojnë në procesin e promovimit.
- viii. Sigurimi i transparencës dhe drejtësisë në proces:
 - a. Komisioni ka për detyrë të sigurojë që procesi i promovimit të jetë i hapur, i drejtë dhe transparent, dhe që çdo kandidat të ketë mundësi të barabarta për të aplikuar për promovim.
- ix. Përgatitja e procedurave të ankesës:
 - a. Komisioni mund të krijojë dhe të menaxhojë procedura ankimi për ata që mendojnë se procesi i promovimit nuk është zhvilluar në mënyrë të drejtë.
 - b. Siguron që çdo ankesë të shqyrtohet me seriozitet dhe transparencë, duke mbajtur integritetin e procesit.
4. Anëtarët e komisioneve të përhershme në nivel institucional vetëkandidohen dhe zgjidhen nga Senati Akademik për një mandate 2 (dy vjeçar), me të drejtë rizgjedhje.
5. Anëtarët e komisioneve të përhershme në nivel njësie kryesore në UV janë:
 - a) *Komisioni i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për çdo njësi kryesore (KSBCF).*
Ky komision përbëhet nga nga 5 (pesë) anëtarë, nga të cilët 4 (katër) janë anëtarë nga personeli akademik i njësisë kryesore që i përkasin kategorisë “Profesor” ose/ dhe “Lektor” dhe 1 (një) anëtar është përfaqësues i studentëve.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

Funksionet e këtij komisioni lidhen me garantimin e standardeve shtetërore të cilësisë për programet e studimit si dhe shërbimet ndaj studentëve. Komisioni ushtron kryesisht këto funksione:

- i. Ndjek zbatimin në nivel njësie kryesore të politikave të miratuara prej SA-së dhe organeve të tjera kolegjiale në fushën e sigurimit të cilësisë dhe vlerësimin e programeve të studimit.
- ii. Rishikon në mënyrë periodike instrumentat që përdor njësia kryesore për sigurimin e brendshëm të cilësisë dhe propozon përmirësimet e nevojshme sipas rastit;
- iii. Realizon studime për të vlerësuar efikasitetin e programeve të studimit të ofruara nga Njësia Kryesore;
- iv. Harton rekomandime në mbështetje të rezulateve të nxjerr prej instrumentave të ndryshëm që NJSBCVI/njësia kryesore përdor për sigurimin e cilësisë, si dhe i përcjell për miratim pranë KSBCI;
- v. Monitoron zbatimin e planit të masave për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies për lëndët e cdo programi studimi.
- vi. Mbështet procesin e vlerësimit të jashtëm për akreditimin e programeve të studimit të ofruara nga Njësia Kryesore, duke ofruar ekspertizë GVB-ve në hartimin e RVB-së;
- vii. Miraton paraprakisht sipas rastit, planet e veprimit në përmbushje të rekomandimeve prej vlerësimit të jashtëm në kuadër të akreditimit të programeve të studimit që ofron njësia kryesore, si dhe ndjek zbatimin e tyre;
- viii. Monitoron planet e veprimit në përmbushje të rekomandimeve të Bordit të Akreditimit për akreditimin e programeve të studimit;
- xii. Bashkëpunon me struktura të tjera në nivel institucioni si dhe bashëkpuntorë të jashtëm për organizimin e aktiviteteve në përmbushje të standarteve për programet e studimit;
- xiii. Brenda muajit shtator të çdo viti kalendarik, harton dhe publikon raportin vjetor të veprimtarisë së tij me gjetjet dhe rekomandimet për përmirësimin e cilësisë së shërbimeve akademik dhe administrative në njësinë kryesore përkatëse;
- xiv. Hartojnë rregulloren e vet si dhe planin e punës;
 - ix. Kryen çdo funksion tjetër të ngarkuar nga autoritetet dhe organet drejtuese të UV-s në fushën e sigurimit të cilësisë të programeve të studimit;

Gjatë ushtrimit të veprimtarisë së saj KSBCF mbështetet nga strukturat/organet e tjera në nivel njësie kryesore/nivel institucioni të ngritura me qëllim sigurimin e brendshëm të cilësisë.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

b) *Komisioni i Dhënies së Gradës Shkencore "Doktor" për çdo njësi kryesore (KDGDF).*

Ky komision përbëhet nga 5 (pesë) anëtarë nga personeli akademik i njësisë kryesore që i përket kategorisë "Profesor". Anëtarët e këtij komisioni kanë mandat dyvjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje.

Komisioni ka disa funksione dhe detyra kryesore që lidhen me procesin e dhënies së gradës shkencore "Doktor". Disa nga funksionet kyçe janë:

- i. Përgatitja dhe miratimi i rregulloreve dhe kriterëve për dhënien e gradës:
 - a. Komisioni është përgjegjës për hartimin dhe miratimin e rregulloreve dhe kriterëve që përcaktojnë standardet akademike dhe shkencore për dhënien e gradës "Doktor".
 - b. Sigurimi që kriteret për aplikimin dhe mbrojtjen e disertacionit janë të qarta dhe të përshtatshme për kërkesat shkencore të fushës përkatëse.
- ii. Mbikëqyrja e procesit të aplikimit për doktoraturë:
 - a. Komisioni shqyrton dhe miraton aplikimet e studentëve që dëshirojnë të ndjekin studimet doktorale.
 - b. Kjo përfshin vlerësimin e temave të disertacioneve dhe përputhshmërinë e tyre me fushat e kërkimit shkencor, si dhe vlerësimin e kualifikimeve të kandidatëve për të hyrë në programin e doktoraturës.
- iii. Emërimi i udhëheqësve të doktoraturës dhe komisioneve të mbrojtjes:
 - a. Komisioni ka përgjegjësinë për emërimin e udhëheqësve të doktoraturës dhe komisioneve të mbrojtjes së disertacioneve, duke siguruar që ata të jenë ekspertë në fushën përkatëse dhe të kenë përvojë të mjaftueshme për të vlerësuar dhe mbështetur kandidatët.
- iv. Vlerësimi i avancimit të kandidatit:
 - a. Komisioni ndihmon në monitorimin dhe vlerësimin e avancimit të studentëve të doktoraturës gjatë periudhës së studimeve të tyre.
 - b. Ai mund të ofrojë rekomandime për përmirësimin e punës shkencore dhe mund të organizojë takime për vlerësimin e progresit të kandidatëve.
- v. Organizimi i mbrojtjes së disertacionit dhe dhënia e gradës:
 - a. Komisioni është përgjegjës për organizimin e mbrojtjes së disertacioneve të doktoratës dhe për sigurimin që kjo mbrojtje të zhvillohet në përputhje me standardet shkencore dhe akademike.
 - b. Pas mbrojtjes së disertacionit, komisioni vlerëson punën e kandidatëve dhe, nëse është e përshtatshme, i jep gradën "Doktor" kandidatit.
- vi. Vlerësimi i cilësisë shkencore dhe origjinalitetit të punës kërkimore:
 - a. Komisioni siguron që puna kërkimore e kandidatëve të jetë e shkëlqyer dhe e bazuar në kërkime origjinale.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI “ISMAIL QEMALI” VLORE
SENATI AKADEMIK

- b. Ai është përgjegjës për vlerësimin e cilësisë shkencore të disertacioneve dhe për mbështetje për zhvillimin e kërkimeve shkencore.
 - vii. Konsultimi dhe mbështetja për kandidatët:
 - a. Komisioni ofron mbështetje dhe këshilla për kandidatët gjatë gjithë periudhës së studimeve doktorale, duke siguruar që ata të kenë burimet dhe ndihmën e nevojshme për të realizuar kërkimet e tyre shkencore dhe për të përmbushur detyrimet e programit.
 - viii. Raportimi dhe dokumentimi i procesit:
 - a. Komisioni është përgjegjës për mbajtjen e dokumentacionit të detajuar për procesin e dhënies së gradës “Doktor”, duke siguruar që çdo hap i këtij procesi të dokumentohet dhe të jetë në përputhje me rregulloret dhe politikat akademike.
 - ix. Sigurimi i përputhshmërisë me normat dhe rregulloret ndërkombëtare:
 - a. Komisioni siguron që procesi i dhënies së gradës “Doktor” të jetë në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe kërkesat e institucioneve arsimore të tjera, duke mundësuar një nivel të lartë të cilësisë akademike dhe shkencore.
- Në përgjithësi, Komisioni i Dhënies së Gradës Shkencore "Doktor" është një organ që siguron që procesi i dhënies së kësaj grade të zhvillohet në mënyrë të drejtë, transparente dhe të bazuar në kritere shkencore të larta. Ai ka rol të rëndësishëm në mbështetje të zhvillimit të kërkimit shkencor dhe të nivelit të lartë akademik.
- c) *Komisioni i Marrëdhënieve me Studentët në nivel njësie kryesore (KMSF).*
Ky komision përbëhet nga nga 5 (pesë) anëtarë, nga të cilët 4 (katër) janë anëtarë nga personeli akademik i njësisë kryesore që i përkasin kategorisë “Profesor” ose/ dhe “Lektor” dhe 1 (një) anëtar është përfaqësues i studentëve.
- Funksionet kryesore të këtij komisioni lidhen me garantimin e standardeve të marrëdhënieve të institucionit me studentët, alumni dhe këshillimin e karrierës. KMSF i kushton një vëmendje të veçantë marrëdhënieve të institucionit me studentët, shërbimeve ndihmës akademike dhe administrative ndaj tyre, si dhe marrëdhënieve të tyre me personelin, strukturat, autoritetet/organet drejtuese të institucionin. Komisioni ushtron kryesisht këto funksione:
- i. Marrëdhënia dhe mbështetje për studentët:
 - Sigurimi i mbështetjes për studentët në lidhje me çështje akademike dhe administrative.
 - Ofrimi i këshillave dhe ndihmës për probleme të ndryshme që mund të hasin studentët gjatë studimeve të tyre.
 - ii. Përfaqësimi i interesave të studentëve:



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE SENATI AKADEMIK

- Komisioni ndihmon në përfaqësimin e interesave të studentëve para administratës dhe trupit akademik.
- Organizimi i takimeve dhe komunikimit me studentët për të mbledhur informacion dhe mendime mbi çështje që lidhen me jetën akademike dhe shërbimet.
- iii. Zhvillimi dhe përmirësimi i politikave për studentët:
 - Komisioni mund të ketë rol në zhvillimin e politikave dhe rregulloreve që ndikojnë në jetën studentore, siç janë afatet akademike, programet e studimit, dhe mundësitë për zhvillim profesional.
- iv. Organizimi i aktiviteteve studentore:
 - Komisioni mund të mbështesë organizimin e aktiviteteve dhe ngjarjeve që promovojnë angazhimin e studentëve, si aktivitete kulturore, sportive dhe sociale.
 - Krijimi i mundësive për studentët që të zhvillojnë shkathtësi dhe të angazhohen në aktivitete jashtë mësimit të klasës.
- v. Menaxhimi i ankesave dhe shqetësimeve:
 - Komisioni mund të mbajë një sistem për menaxhimin e ankesave dhe shqetësimeve të studentëve që lidhen me çështje akademike ose administrative, duke siguruar një zgjidhje të drejtë dhe efikase.
- vi. Konsultime dhe orientim akademik:
 - Ofrimi i shërbimeve të orientimit për studentët, duke i ndihmuar ata të kuptojnë mundësitë akademike dhe mundësitë për zhvillim profesional pas përfundimit të studimeve.
- 6. Anëtarët e komisioneve të përhershme në nivel njësie kryesore vetëkandidohen dhe zgjidhen nga asambleja e personelit akademik të njësisë kryesore midis anëtarëve të saj, për një mandat dyvjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje.
- 7. Funksione të tjera dhe mënyra e funksionimit të komisioneve të përhershme përcaktohet në Rregulloren e Universitetit.

Neni 23

Bordi i Administrimit

1. Bordi i Administrimit është organi më i lartë kolegjal administrativ i Universitetit, i cili garanton mbarëvajtjen financiare dhe administrative të tij.
2. Bordi përbëhet nga 7 anëtarë, të punësuar me kohë të pjesshme.
3. Anëtarët, përfaqësues të UV-së, vetëkandidohen dhe përzgjidhen nga Senati Akademik për një mandat pesëvjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje. Vendi i mbetur vakant plotësohet sipas renditjes në listën përkatëse të kandidatëve gjatë votimit.
4. Anëtarët përfaqësues të ministrisë përgjegjëse për arsimin e lartë ose të njësisë së qeverisjes vendore zgjidhen nga titullarët përkatës.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

5. Nëse institucioni siguron vetë pesëdhjetë për qind ose më shumë të buxhetit afatmesëm, katër prej anëtarëve janë përfaqësues të UV-së dhe tre janë përfaqësues të ministrisë përgjegjëse për arsimin.
6. Në rastet kur institucioni siguron vetë më pak se pesëdhjetë për qind të buxhetit afatmesëm, tre prej anëtarëve janë përfaqësues të IAL-së dhe katër janë përfaqësues të ministrisë përgjegjëse për arsimin.
7. Në rastet kur njësia e qeverisjes vendore, në territorin e së cilës zhvillon veprimtarinë institucioni i arsimit të lartë, kontribuon financiarisht, së paku në masën prej dhjetë për qind të buxhetit afatmesëm të IAL-së, atëherë një prej përfaqësuesve, që i takon ministrisë përgjegjëse për arsimin, përcaktohet nga njësia e qeverisjes vendore.

Neni 24

Mbarimi i mandatit të anëtarit të Bordit të Administrimit

1. Mandati i anëtarit të Bordit të Administrimit mbaron kur:
 - a) përmbushet afati i mandatit;
 - b) jep dorëheqjen;
 - c) largohet nga UV-ja për përfaqësuesit e vetë;
 - d) shkarkohet nga Senati Akademik me jo më pak se 4/5 (katër të pestat) e votave të anëtarëve, për përfaqësuesit e vet;
 - e) dënohet me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një krimi;
 - f) bëhet i paafte fizikisht ose mendërisht për të kryer detyrat e tij;
 - g) nuk merr pjesë, për 3 herë rradhazi, pa shkaqe të arsyeshme, në mbledhjet e bordit të administrimit;
 - h) lirohet me akt të Ministrit/Kryetarit të Bashkisë/Biznesit për përfaqësuesit e tyre.
 - i) nuk jeton më.
2. Mënyra e thirrjes së mbledhjeve, rendi i ditës, pjesëmarrja, votimi, procedurat e votimit dhe çështjet e tjera të lidhura me to, parashikohen në rregulloren e brendshme të Bordit të Administrimit.

Neni 25

Funksionet e Bordit të Administrimit

1. Bordi i Administrimit ka këto funksione kryesore:
 - a) garanton qëndrueshmërinë financiare të institucionit të arsimit të lartë dhe përmbushjen e misionit të tij;
 - b) me propozim të Senatit Akademik, miraton planin strategjik të zhvillimit të institucionit dhe mbikëqyr zbatimin e tij;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI “ISMAIL QEMALI” VLORE
SENATI AKADEMIK**

- c) me propozim të Senatit Akademik, miraton buxhetin vjetor dhe atë afatmesëm të institucionit dhe mbikëqyr zbatimin e tyre;
- ç) me propozim të Senatit Akademik, miraton numrin e personelit në të gjitha nivelet;
- d) vlerëson paraprakisht mbylljen dhe riorganizimin e institucionit të arsimit të lartë, si dhe ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë me një institucion tjetër të arsimit të lartë;
- dh) miraton paraprakisht hapjen, riorganizimin ose mbylljen e njësive përbërëse të institucionit të arsimit të lartë;
- e) jep mendim për projekt-rregulloren e institucionit dhe miraton rregulloren financiare të tij;
- ë) përcakton rregullat për shpërndarjen e të ardhurave që siguron institucioni nga ushtrimi i veprimtarive të tij, si dhe mbikëqyr përdorimin e burimeve të financimit;
- f) është përgjegjës për caktimin e kriterëve e të procedurave për punësimin e administratorëve dhe personelit administrativ, mbështetur në aktet e institucionit të arsimit të lartë;
- g) emëron dhe shkarkon administratorin e institucionit;
- gj) miraton paraprakisht statutin e institucionit të arsimit të lartë, para se t’i përcillet Senatit Akademik me jo më pak se tre të pestën e votave të anëtarëve të tij;
- h) miraton raportin e detajuar vjetor të veprimtarisë së institucionit, të hartuar nga rektorati;
- i) me propozim të Senatit Akademik, miraton tarifat e shkollimit;
- j) shqyrton dhe miraton për çdo vit akademik jo më vonë se muaji dhjetor listën e studentëve të kategorive të individëve që përjashtohen nga tarifat e shkollimit në të gjitha ciklet e studimit;
- k) përcakton procedurat dhe masën e kompesimit dhe rimbursimit financiar për personelin akademik që punon për aktivitetet e mësimdhënies, punës kërkimore-shkencore, kontributit institucional dhe kontributit profesional;
- l) përcakton pagat e personelit akademik të të gjitha kategorive pasi ka marrë mendimin e Senatit Akademik, por jo më shumë se kufijtë maksimalë të pagës për funksion/titull të përcaktuara sipas legjislacionit në fuqi;
- ll) me propozim të Senatit Akademik, miraton pagesën e pedagogëve për mbingarkesën mësimore;
- m) përcakton dhe miraton masën e shpërblimit të anëtarëve të Bordit të Administrimit, Senatit Akademik;
- n) përcakton dhe miraton masën e shpërblimit të anëtarëve të komisioneve të përhershme;
- nj) miraton kategoritë e personelit administrativ dhe nivelet e pagave sipas legjislacionit në fuqi;
- o) miraton nivelin e pagave të personelit ndihmës akademik sipas legjislacionit në fuqi;
- p) shfuqizohet;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

- q) merr në shqyrtim dhe vendos për çdo kërkesë tjetër me karakter financiar;
 - r) harton, ndryshon dhe miraton rregulloren e tij të brendshme;
 - rr) miraton fonde për ndihmë financiare për të gjitha kategoritë e personelit që dalin në pension, sëmundje të rëndë si dhe në rast vdekjeje të punonjësit, ose të një anëtarit të familjes së punonjësit sipas përcaktimeve ligjore;
 - s) vendos për trajtimin financiar për studentët e ekselencës;
 - sh) thërret Administratorin për raportim mbi veprimtarinë financiare dhe realizimin e buxhetit në Universitetin "Ismail Qemali", Vlorë në përfundim të çdo viti akademik;
 - t) informon Senatin Akademik dhe Rektorin për situatën dhe qëndrueshmërinë financiare, realizimin e buxhetit, shkaqet dhe përgjegjësitë në rast mosrealizimi të tij, si dhe për projektet përkatëse financiare për të gjithë Universitetin.
2. Në veprimtarinë e tij, Bordi i Administrimit mbështetet nga administrata e Rektoratit, sipas natyrës së problemeve që paraqiten rast pas rasti për shqyrtim, duke i paraqitur Rektorit kërkesë paraprakisht.
3. Bordi i Administrimit publikon të gjitha vendimet e marra prej tij konform përcaktimeve të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008, "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar dhe ligjit nr.119/2014, datë 18.09.2014, "Për të drejtën e informimit".

Neni 26
Rektorati

1. Rektorati në institucionet e arsimit të lartë është organ kolegjal që drejtohet nga Rektori dhe përbëhet nga:
- a) Rektori;
 - b) Zëvendësrektori/ët;
 - c) Administratori i institucionit;
 - d) Drejtuesit e njësive kryesore.
2. Rektorati në mbledhjet e tij mund të ftojë edhe personel tjetër në varësi të natyrës specifike të çështjes së shtruar për diskutim.
3. Rektorati ka këto funksione kryesore:
- a. harton dhe paraqet në Senatin Akademik projekt-planin e zhvillimit strategjik të institucionit;
 - b. formulon kriteret për shpërndarjen e burimeve financiare, materiale dhe njerëzore;
 - c. përcakton përparësitë në plotësimin e kërkesave të njësive të institucionit për financime, mbi të cilat do të hartohet projekt-buxheti vjetor;
 - d. propozon rekomandime në SA për programet e studimit dhe kërkimit shkencor dhe ndryshimet e nevojshme strukturore për realizimin e tyre;
 - e. propozon rekomandime në SA për strukturën e përgjithshme dhe numrin e personelit për të gjitha nivelet;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

- f. propozon në SA, për miratim, planin vjetor të veprimtarive akademike dhe kërkimore shkencore;
 - g. propozon në SA, për miratim, raportin e detajuar vjetor të veprimtarisë së institucionit;
 - h. paraqet rekomandime në SA mbi projekt-marrëveshjet, bashkëpunimet apo anëtarësimet e institucionit në organizma apo institucione kombëtare ose ndërkombëtare;
 - i. merr masat e nevojshme për zbatimin e vendimeve të Senatit Akademik që i ngarkohen këtij organi;
 - j. harton dhe paraqet për miratim rregulloren e UV-së;
 - k. propozon në SA Kodin e Etikës.
4. Mbledhja e Rektoratit thirret nga Rektori ose të paktën një e treta e anëtarëve të tij. Për çdo mbledhje të Rektoratit mbahet procesverbal. Rektorati shprehet me vendime për çështjet që merren në shqyrtim.
5. Rektorati harton rregulloren e funksionimit të tij, e cila miratohet nga Senati Akademik.

Neni 27

Dekanati

1. Dekanati në institucionet e arsimit të lartë është organ kolegjal që drejtohet nga dekani dhe përbëhet nga:
- a. dekani;
 - b. zëvendësdekanët;
 - c. administratori i njësisë kryesore;
 - d. drejtuesit e njësive bazë.
2. Dekanati ka këto funksione kryesore:
- a. koordinon veprimtarinë e njësive bazë të fakultetit;
 - b. diskuton dhe propozon në rektorat masa për zhvillimin dhe funksionimin e njësive kryesore;
 - c. diskuton paraprakisht probleme që lidhen me programet e studimit, kriteret e pranimit në këto programe, shpërndarjen e financimeve dhe përparësitë e zhvillimit të fakultetit;
 - d. diskuton dhe paraqet në Senatin Akademik projekt-planin e zhvillimit strategjik të njësive kryesore mbi bazën e propozimeve të njësive bazë;
 - e. përcakton dhe propozon në rektorat përparësitë në plotësimin e kërkesave të njësive të njësive bazë për financime, mbi të cilat do të hartohet projektbuxheti vjetor;
 - f. paraqet rekomandime në Rektorat dhe SA mbi programet e studimit dhe kërkimit shkencor dhe ndryshimet e nevojshme strukturore për realizimin e tyre, sipas propozimeve të njësive bazë;
 - g. paraqet në Rektorat për miratim planin vjetor të veprimtarive akademike dhe kërkimore shkencore të njësive kryesore, sipas propozimeve të njësive bazë;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË SENATI AKADEMIK

- h. paraqet në Rektorat për miratim raportin e detajuar vjetor të veprimtarisë së fakultetit, mbështetur në raportet e hartuara nga njësitë bazë;
 - i. merr masat e nevojshme për zbatimin e vendimeve të Senatit Akademik, Rektoratit, Rektorit dhe zëvendësrektorëve;
 - j. harton dhe miraton paraprakisht rregulloren e brendshme të funksionimit të fakultetit, dhe çdo lloj rregullore tjetër, përpara miratimit përfundimtar nga SA;
 - k. jep lejet etike për të kryer kërkim/mbledhur të dhëna për punimet dhe projektet kërkimore shkencore;
 - l. kompetenca më të detajuara përcaktohen në rregulloren e Universitetit.
3. Në mbledhjen e dekanatit mund të thirren edhe persona të tjerë sipas nevojës.
 4. Mënyra e thirrjes, e funksionimit dhe e organizimit të dekanatit zhvillohet në përputhje me rregulloren e fakultetit.
 5. Dekanati mbledhet periodikisht dhe për çdo mbledhje mbahet procesverbal i cili duhet të zbardhet të firmoset nga gjithë anëtarët e Dekanatit prezent në mbledhje.
 6. Dekanati shprehet me vendime për çështjet që merren në shqyrtim. Dekanati ushtron funksione të tjera të parashikuara në këtë Statut dhe akte të tjera të Universitetit.

Neni 28

Këshilli i Etikës

1. Këshilli i Etikës i Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë promovon dhe shqyrton çështje, që lidhen me etikën në veprimtarinë e institucionit, në fushën akademike dhe në atë kërkimore-shkencore, si dhe në veprimtaritë e tjera institucionale sipas parashikimeve të Kodit të Etikës dhe legjislacionit për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë.
2. Këshilli i Etikës është organ kolegjal, i cili përbëhet nga 7 (shtatë) anëtarë, katër prej të cilëve personel akademik me kohë të plotë, nga një për çdo fakultet, që mbajnë të paktën gradën shkencore "Doktor", një përfaqësues nga radhët e personelit ndihmës akademik, një nga personeli administrativ dhe një përfaqësues nga radhët e studentëve. Kandidati për anëtar vetëkandidohet dhe zgjidhet nga Senati Akademik, me shumicë të thjeshtë të të gjithë anëtarëve dhe votim të fshehtë. Çdo njësi kryesore nuk mund të përfaqësohet me më shumë se një anëtar në Këshillin e Etikës. Mandati i anëtarit të Këshillit të Etikës është pesëvjeçar me të drejtë rizgjedhje. Ky mandat përfundon me konstituimin e Këshillit të ri të Etikës.
3. Nuk mund të zgjidhet anëtar në Këshillin e Etikës personeli akademik i emëruar në funksione drejtuese.
4. Këshilli i Etikës vihet në lëvizje përmes ankesave. Vendimmarrja kryhet me shumicë të cilësuar prej katër të pestave.
5. Këshilli i Etikës, në bashkëpunim me Rektoratin, përgatit dhe i propozon Senatit Akademik, Kodin e Etikës së Universitetit. Projekt-kodi i përgatitur nga Këshilli i Etikës, përpara se të



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

dërgohet për miratim në Senatin Akademik duhet të kalojë për konsultim në të gjitha njësitë kryesore si dhe zyrën juridike të UV-së.

6. Këshilli i Etikës në rastin e shqyrtimit të çështjeve që lidhen me etikën në veprimtarinë e universitetit shprehet me vendim dhe i propozon Rektorit marrjen e masës disiplinore. Vendimi i Këshillit të Etikës është i ankimueshëm në Gjykatë.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI “ISMAIL QEMALI” VLORE
SENATI AKADEMIK**

**KREU IV
AUTORITETET DREJTUESE**

**Neni 29
Klasifikimi i autoriteteve drejtuese**

1. Autoritetet drejtuese në Universitetin “Ismail Qemali”, Vlorë ndahen në autoritete drejtuese akademike dhe administrative.
2. Autoritete drejtuese akademike janë rektori, drejtuesi i njësisë kryesore dhe drejtuesi i njësisë bazë.
3. Autoritete drejtuese administrative janë administratori i institucionit, administratori i njësisë kryesore dhe administratori i njësisë bazë.

**Neni 30
Rektori**

1. Rektori është autoriteti më i lartë akademik i UV-së, si dhe përfaqësuesi ligjor i tij për çështjet akademike dhe protokollare.
2. Rektori i UV-së, me cilësinë e titullarit të IAL-së, është anëtar i Konferencës së Rektorëve.
3. Rektori mban titullin “Profesor” dhe mund të vijë nga radhët e personelit akademik të institucionit të arsimit të lartë ose dhe jashtë tij.
4. Rektori zgjidhet nga anëtarët e asambleve të personelit akademik të njësive kryesore dhe studentët. Votat e studentëve në përzgjedhjen e rektorit llogariten në masën dhjetë për qind të totalit të përgjithshëm të votave. Kandidatët për rektor vetëkandidohen dhe duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme:
 - a. Nuk kanë qenë në ndjekje penale dhe ndaj tyre nuk është dhënë një masë e sigurimit personal;
 - b. Të kenë përvojë në mësimdhënie ose kërkim shkencor jo më pak se 10 (dhjetë) vjet;
 - c. Të kenë përvojë administrative në drejtimin e njësive bazë, kryesore dhe institucionit.
 - d. Të mos jenë dënuar për vepra penale me vendim gjyqësor të formës së prerë;
 - e. Të mos kenë masë disiplinore në fuqi
 - f. Të mos kenë papajtueshmëri në kuptim të ligjit nr. 45/2015 (“Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”) dhe ligjit nr. 138/2015 (“Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”);
 - g. Të mos kenë qenë rektorë të zgjedhur për dy ose më shumë mandate, të njëpasnjëshme ose të ndara në të njëjtin institucion ku do të kandidojnë. Në numrin e mandateve, sipas kësaj pike, llogariten mandatet e fituara sipas ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007, “Për arsimin e lartë



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE SENATI AKADEMIK

- në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të gjitha mandatet e tjera në vijim, të fituara me zgjedhje, pavarësisht kohëzgjatjes.
5. Rektori nuk mund të jetë anëtar i Bordit të Administrimit. Funkzioni i tij është i papajtueshëm me funksionet e përgjegjësve të strukturave të UV-së, të kryetarit të komisionit të diplomës dhe të provimit të formimit.
 6. Mandati i rektorit zgjat katër vjet. Ai shërben në detyrë për një mandat, me të drejtë rizgjedhje vetëm një herë. Pas përfundimit të mandatit, ai vazhdon të jetë anëtar i personelit të njësisë bazë ku kryen veprimtarinë e tij akademike.
 7. Rektori i zgjedhur dekretohet nga Presidenti i Republikës.
 8. Rektori largohet nga detyra:
 - a. kur mbaron mandatin;
 - b. kur jep dorëheqjen;
 - c. kur nuk jeton më;
 - d. kur mbush moshën e pensionit;
 - e. kur dënohet me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale;
 - f. kur rezulton pozitiv gjatë kontrollit të dekriminalizimit dhe bashkëpunëtorit me sigurimin e shtetit, sipas kuadrit ligjor në fuqi;
 - g. në rastet e kryerjes së veprave penale flagrante;
 - h. në rastet e shkeljeve të rënda të ligjit;
 - i. kur është në kushtet e pamundësisë për të kryer detyrën.
 9. Rektori shkarkohet nga Presidenti i Republikës me propozim të ministrit përgjegjës për arsimin. Në rastin e largimit të rektorit, para përfundimit të mandatit të tij, detyrën e rektorit e kryen një prej zëvendësrektorëve. Ky i fundit komandohet në detyrë nga ministri përgjegjës për arsimin, për një afat deri në gjashtë muaj, me qëllim organizimin e zgjedhjeve.

Neni 31 Funksionet e Rektorit

Rektori ushtron këto funksione:

1. Përfaqëson UV-në në marrëdhënie me të tretët për çështjet akademike dhe protokollare.
2. Drejton Senatin Akademik dhe raporton para tij.
3. Drejton dhe kontrollon veprimtarinë e strukturave të UV-së për çështjet akademike dhe protokollare.
4. I paraqet Senatit Akademik planin strategjik të zhvillimit të UV-së.
5. Paraqet propozime për aktet që janë në kompetencë të Senatit Akademik dhe Bordit të Administrimit.
6. Garanton zbatimin e akteve ligjore e nënligjore, të statutit dhe të rregulloreve të UV-së.
7. I kërkon informacion Bordit të Administrimit për çështje të kompetencës së tij.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

8. I paraqet administratorit të UV-së kërkesat me qëllim përmbushjen e nevojave akademike, administrative dhe financiare.
9. Nënshkruan në emër të UV-së marrëveshje bashkëpunimi me institucione apo organizata kombëtare e ndërkombëtare arsimore e shkencore, lidhjet e binjakëzimit me universitete e shkolla të tjera të larta të vendit e të huaja, si dhe marrëveshjet e bashkëpunimit me organizma joqeveritare, donatorë vendas e të huaj, që mund të ndihmojnë në zhvillimin e universitetit.
10. Nënshkruan marrëveshje bashkëpunimi me karakter financiar, pas miratimit paraprak nga Bordi i Administrimit.
11. Cakton delegacionet dhe jep lejen për kualifikimin dhe specializimin jashtë shtetit të stafit akademik, ndihmësakademik dhe administrativ.
12. Zgjidh çështjet e kompetencës mes organeve dhe drejtuesve të njësive, përveç atyre mes Senatit Akademik dhe Bordit të Administrimit.
13. Miraton paraprakisht, apo kthen për rishqyrtim, marrëveshjet e njësive kryesore dhe të njësive bazë për rastet kur fusha e bashkëpunimit shtrihet brenda juridiksionit të tyre.
14. Mund të kthejë për rishqyrtim apo të anullojë, shfuqizojë vendimet e drejtuesve të njësive kryesore dhe njësive bazë, kur ato bien ndesh me aktet ligjore e nënligjore në fuqi, me këtë statut, rregulloren e UV-së dhe vendimet e Senatit Akademik.
15. Emëron dhe shkarkon zëvendësrektorët, pas miratimit të kandidaturave të propozuara prej tij, në Senatin Akademik.
16. Përcakton fushën e veprimit të zëvendësrektorëve dhe bën ndryshimin e tyre kur e gjen të nevojshme për nevoja të institucionit në rastet dhe mënyrën e parashikuar në Rregullore.
17. Ka të drejtën e delegimit të firmës dhe të kompetencave të tij zëvendësrektorëve.
18. Emëron drejtuesin e njësisë kryesore të shpallur fitues në zgjedhje.
19. Emëron drejtuesin e njësisë kryesore në rastet e krijimit të një njësie kryesore të re, në rastet kur në përfundim të procesit zgjedhor nuk ka kandidat fitues, si dhe në rastet e dorëheqjes së drejtuesit,
20. Miraton dhënien e vitit akademik sabatik sipas përcaktimeve në këtë Statut.
21. Nënshkruan diplomat e përfundimit të studimeve universitare si dhe certifikata, pa të drejtë delegimi të firmës.
22. Miraton transferimin e studentëve të universitetit, në universitete të tjera dhe anasjelltas, bazuar në propozimet e dekanëve të fakulteteve përkatëse.
23. Urdhëron shpalljen e vendeve të lira të punës në faqen web të UV-së.
24. Miraton kriteret e punësimit të personelit akademik (me kohë të plotë dhe me kohë të pjesshme), si dhe të personelit ndihmësakademik me karakter mësimor, sipas propozimeve të njësisë bazë.
25. Miraton kriteret e punësimit të personelit ndihmësakademik me karakter administrativ, sipas propozimeve të njësisë bazë, njësisë kryesore, ose njësisë në nivel institucional, së cilës ky personel do t'i shërbejë.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI “ISMAIL QEMALI” VLORE
SENATI AKADEMIK

26. Urdhëron ngritjen e komisioneve ad hoc për konkursin e punësimit të personelit akademik, dhe personelit ndihmësakademik, sipas përcaktimeve në këtë Statut.
27. Trajton ankesat e subjekteve të interesuara lidhur me procedurat e zhvillimit të konkurimit dhe vendimeve të komisioneve *ad-hoc* për rekrutimin e personelit akademik dhe të personelit ndihmësakademik, sipas procedurave dhe afateve të përcaktuara në ligjin nr. 44/ 2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” dhe në këtë Statut.
28. Urdhëron ngritjen e komisionit të apelimit pranë Rektorit për shqyrtimin e ankimimeve në rastet e parashikuara në pikën 27, sipas parashikimeve të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”.
29. Në përfundim të procesit të ankimimit administrativ, kur vlerëson se ankimi është i pranueshëm, me cilësinë e organit epëror, vendos me një akt të ri anulimin, shfuqizimin ose ndryshimin e vendimit të komisionit *ad-hoc* për rekrutimin e personelit akademik dhe personelit ndihmësakademik.
30. Miraton klasifikimin përfundimtar të konkursit të punësimit të personelit akademik (me kohë të plotë dhe me kohë të pjesshme) dhe të personelit ndihmësakademik.
Emëron kandidatin/ kandidatët e shpallur fitues.
31. Miraton propozimet e njësive bazë për punësimin e personelit akademik të ftuar, kur vlerëson se janë në përputhje me kuadrin ligjor.
32. Nënshkruan kontratat e punës të personelit akademik dhe ndihmësakademik të UV-së.
33. Mbikëqyr zbatimin e vendimeve, masave dhe kërkesave të Senatit Akademik.
34. Ngre komisione e grupe pune për çështje, studime dhe veprimtari të veçanta, si dhe i propozon Bordit të Administrimit shpërblimin përkatës.
35. Miraton leje me kohëzgjatje mbi dy javë për personelin akademik, për aktivitete që lidhen me drejtimit e punës së tyre.
36. Miraton kërkesën e personelit akademik të punësuar me kohë të plotë në UV që të angazhohet me kohë të pjesshme në një institucion tjetër të arsimit të lartë, pas miratimit paraprak edhe të drejtuesit të njësisë bazë, si dhe në marrëveshje mes institucioneve.
37. Kur i kërkohet ose me iniciativën e tij, merr pjesë pa të drejtë vote në mbledhjet e organeve dhe njësive përbërëse të UV-së, në të cilat nuk është anëtar.
38. Organizon ose ushtron kontrolle në fakultete, për cilësinë e mësimdhënies, kërkimin shkencor, si dhe çdo çështje tjetër akademike në kompetencë të fakulteteve.
39. Ushtron të drejtën e dhënies së masave disiplinore ndaj personelit akademik dhe personelit ndihmësakademik.
40. Urdhëron, pas propozimit të drejtuesit të njësisë bazë dhe pas miratimit të komisionit *ad hoc* ku personeli akademik zhvillon veprimtarinë e tij, largimin nga detyra të personelit akademik të UV-së në rastet e shkeljeve të rënda dhe të përsëritura të ligjit, sipas përcaktimeve në Statut dhe në aktet e tjera të IAL-së.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI “ISMAIL QEMALI” VLORE
SENATI AKADEMIK**

41. Urdhëron, pas propozimit të drejtuesit të njësive kryesore ose drejtuesit të njësive bazë, ose konstatimit kryesisht, largimin nga detyra dhe zgjidhjen e marrëdhënies së punës me personelin ndihmësakademik të UV-së, sipas parashikimeve të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.
42. Shfuqizohet.
43. Urdhëron zgjidhjen e menjëhershme të marrëdhënies së punës me personelin akademik, ndihmësakademik, sipas parashikimeve të ligjit nr. 7961, datë 12. 07. 1995 “Kodin i Punës të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.
44. Urdhëron, pas propozimit të drejtuesit të njësive kryesore, shkarkimin e autoritetit drejtues të njësive bazë në UV, në rastet e kryerjes së veprave penale flagrante ose të shkeljeve të rënda të ligjit, të pamundësisë për të kryer detyrën dhe për rastet e parashikuara në Kodin e Etikës së institucionit të arsimit të lartë. Rektori shprehet brenda një muaji. Zëvendësuesi i drejtuesit të njësive bazë caktohet nga rektori, me propozimin e drejtuesit të njësive kryesore. Rektori shpall zgjedhje të parakohshme brenda gjashtë muajve nga data e shkarkimit.
45. Rektori i propozon ministrit përgjegjës për arsimin shkarkimin e autoritetit drejtues të njësive kryesore të institucionit publik, në rastet e kryerjes së veprave penale flagrante ose të shkeljeve të rënda të ligjit, të pamundësisë për të kryer detyrën dhe për rastet e parashikuara në Kodin e Etikës së UV-së. Rektori, brenda dy muajve nga data e shkarkimit, cakton njërin prej zëvendësve të autoritetit deri në zgjedhjen e autoritetit të ri. Rektori, menjëherë pas shkarkimit, shpall zgjedhje të parakohshme, të cilat kryhen brenda gjashtë muajve nga data e shkarkimit.
46. Autorizon në rast nevojë hyrjen e forcave të rendit në mjediset e universitetit.
47. Marrëdhëniet e Rektorit me organet e tjera, mënyra dhe kushtet e ushtrimit të kompetencave të tij parashikohen në Rregulloren e UV-së.
48. Rektori në ushtrim të kompetencave të tij, shprehet me vendime, urdhëra dhe akte të tjera sipas legjislacionit në fuqi.

**Neni 32
Zëvendësrektori**

1. Rektori në ushtrimin e kompetencave të veta ndihmohet nga 2 (dy) zëvendësrektorë.
2. Zëvendësrektorët i përkasin kategorisë “Profesor” ose kanë gradën shkencore “Doktor” (“PhD”), të fituar pranë universiteteve të vendeve anëtare të OECD-së ose BE-së. Ata janë anëtarë të personelit akademik me kohë të plotë, të cilët emërohen dhe shkarkohen nga Rektori pas miratimit të kandidaturave të propozuara prej tij në Senatin Akademik.
3. Zëvendësrektorët kryejnë detyra të përcaktuara nga Rektori dhe në mungesë, me porosi e në emër të tij, kryhen veprimet dhe nënshkruan aktet përkatëse, përveç atyre për të cilat sipas ligjit për arsimin e lartë dhe këtij statuti janë ekskluzivitet i rektorit.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

Neni 33

Papajtueshmëria me funksionin e zëvendësrektorit

Rastet e papajtueshmërisë me funksionin e zëvendësrektorit janë:

- a. kur është anëtar i Bordit të Administrimit;
- b. kur është anëtar i Këshillit të Etikës;
- c. kur ushtron funksionin e koordinatorit të studentit.

Neni 34

Drejtuesi i njësisë kryesore

1. Drejtuesi i njësisë kryesore është dekani i fakultetit. Ai drejton asamblenë e personelit akademik të njësisë kryesore.
2. Dekani është autoriteti më i lartë akademik i njësisë kryesore dhe përfaqësuesi i saj. Ai koordinon veprimtarinë e njësive bazë dhe organeve kolegjiale të njësisë kryesore si edhe zgjidh mosmarrëveshjet ndërmjet tyre.
3. Dekani zgjidhet nga asambleja e personelit akademik të njësisë kryesore dhe studentët. Votat e studentëve në përzgjedhjen e drejtuesit llogariten në masën dhjetë për qind të totalit të përgjithshëm të votave. Kandidati për drejtues vetëkandidohet. Ai është personel akademik i kategorisë "Profesor" dhe mund të vijë nga radhët e personelit akademik të institucionit të arsimit të lartë ose dhe jashtë tij.
4. Kandidatët për dekan duhet:
 - a) të kenë përvojë në mësimdhënie ose kërkim shkencor jo më pak se 10 vjet;
 - b) të kenë përvojë akademike në cilësinë e titullarit të disiplinave të lëndëve, si dhe të kenë zhvilluar kurrikula, programe lëndësh, të kenë përgatitur literaturë mbështetëse dhe/ose të kenë zhvilluar projekte kërkimore etj., prej të paktën 5 vitesh;
 - c) të mos kenë masë disiplinore në fuqi;
 - d) të mos jenë dënuar më parë me një vendim të formës së prerë për vepra penale;
 - e) të mos ketë papajtueshmëri në kuptim të ligjit nr. 45/2015 "Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë" dhe ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".
5. Mandati i drejtuesit zgjat katër vjet. Ai shërben në detyrë për një mandat, me të drejtë rizgjedhjeje vetëm një herë. Pas përfundimit të mandatit, ai vazhdon të jetë anëtar i personelit të njësisë bazë ku kryen veprimtarinë e tij akademike.
6. Rektori i Universitetit emëron drejtues të njësisë kryesore kandidatin fitues, të dalë nga zgjedhjet.
7. Kur vendi i Dekanit mbetet i lirë, si pasojë e përfundimit të parakohshëm të mandatit për arsytet e paracaktuara në ligjin nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" dhe në Statut, Rektori komandon në detyrë një nga zëvendësdekanët.

8. Drejtuesi i njësisë kryesore në UV ushtron këto funksione:

- a) përfaqëson njësinë kryesore në organet e UV-së dhe në marrëdhënie me të tretët për çështjet akademike dhe protokollare;
- b) drejton dekanatin dhe raporton para tij;
- c) drejton dhe kontrollon veprimtarinë e strukturave të njësisë kryesore për çështjet akademike dhe protokollare;
- d) garanton zbatimin e akteve ligjore e nënligjore, të statutit dhe të rregulloreve të UV-së në njësinë kryesore;
- e) i përcjell Senatit Akademik propozimet e njësive bazë, shoqëruar me mendimet e tij;
- f) i përcjell rektorit propozimet e njësive bazë, shoqëruar me mendimet e tij;
- g) i paraqet Rektorit kërkesat e njësisë kryesore me qëllim përmbushjen e nevojave akademike, administrative dhe financiare;
- h) emëron drejtues të njësisë bazë kandidatin fitues në zgjedhje;
- i) emëron drejtuesin e njësisë bazë në rastet e krijimit të një njësie bazë të re, në rastet kur në përfundim të procesit zgjedhor nuk ka kandidat fitues, si dhe në rastet e dorëheqjes së drejtuesit, dhe ia përcjell këtë emënim rektorit për miratim përfundimtar;
- j) emëron drejtuesit e grupeve mësimore e kërkimore-shkencore (nga kategoria e personelit akademik "Profesor" dhe grada shkencore "Doktor");
- k) emëron dhe shkarkon zëvendësdekanin;
- l) i propozon rektorit shkarkimin e autoritetit drejtues të njësisë bazë në institucionet publike të arsimit të lartë në rastet e kryerjes së veprave penale flagrante ose të shkeljeve të rënda të ligjit, të pamundësisë për të kryer detyrën dhe rastet e parashikuara në Kodin e Etikës së institucionit të arsimit të lartë. Rektori shprehet brenda një muaji. Zëvendësuesi i drejtuesit të njësisë bazë caktohet nga rektori, me propozimin e drejtuesit të njësisë kryesore;
- m) i propozon rektorit largimin nga detyra dhe zgjidhjen e marrëdhënies së punës me personelin ndihmësakademik të njësisë kryesore, sipas parashikimeve të ligjit nr.7961, datë 12.07.1995 "Kodi i Punës të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar;
- n) i propozon rektorit zgjidhjen e menjëhershme të marrëdhënies së punës me personelin akademik dhe ndihmësakademik të njësisë kryesore, sipas parashikimeve të ligjit nr.7961, datë 12.07.1995 "Kodi i Punës të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar;
- o) harton planin kalendarik;
- p) i përcjell organeve dhe autoriteteve drejtuese të UV-së të gjitha aktet që dalin nga njësiti bazë dhe njësia kryesore që drejton, të shoqëruara me mendimet e tij;
- q) miraton propozimin e njësisë bazë për përbërjen e komisioneve të provimeve të formimit, të mbrojtjes së diplomave;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

- r) nënshkruan diplomat dhe çertifikatat e përfundimit të studimeve pa të drejtë të delegimit të firmës;
 - s) marrëdhëniet e drejtuesit të njësisë kryesore me organet e tjera, mënyra dhe kushtet e ushtrimit të kompetencave të tij, parashikohen në Rregulloren e UV-së.
 - t) i propozon administratorit të institucionit shkarkimin e administratorit të njësisë kryesore.
9. Drejtuesi i njësisë kryesore në ushtrim të kompetencave të tij, shprehet me urdhëra dhe akte të tjera sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 35

Mbarimi i mandatit të dekanit

1. Mandati i dekanit mbaron kur:
 - a. përfundon afati i mandatit;
 - b. jep dorëheqjen;
 - c. në rastin e shkarkimit sipas parashikimeve në ligjin për arsimin e lartë;
 - d. është në kushtet e pamundësisë për të ushtruar detyrën;
 - e. nuk jeton më.

Neni 36

Zëvendësdekan

1. Dekani, në ushtrimin e funksioneve të tij, ndihmohet nga zëvendësdekanët. Zëvendësdekanët janë anëtarë me kohë të plotë të personelit akademik dhe kanë së paku gradën shkencore "Doktor".
2. Numri i zëvendësdekanëve, emërimi dhe shkarkimi i tyre përcaktohet nga vetë dekani me vendim sipas nevojave të njësisë kryesore. Numri i zëvendësdekanëve nuk mund të jetë më shumë se dy.
3. Kompetencat e zëvendësdekanëve përcatohen në Rregulloren e Brendshme të UV-së.

Neni 37

Papajtueshmëria me funksionin e zëvendësdekanit

Rastet e papajtueshmërisë me funksionin e zëvendësdekanit janë:

- a. kur është anëtar i Bordit të Administrimit;
- b. kur është anëtar i Këshillit të Etikës;
- c. kur është autoritet drejtues i njësisë bazë ose i qendrës kërkimore-shkencore pranë njësisë bazë.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK**

Neni 38

Drejtuesi i njësisë bazë

1. Drejtuesi i njësisë bazë është drejtuesi i departamentit ose i qendrës kërkimore-shkencore. Ai është autoriteti drejtues akademik i asaj njësie dhe e përfaqëson atë. Në institucionet publike të arsimit të lartë ai zgjidhet nga asambleja e personelit akademik të njësisë bazë. Ai zgjidhet nga personeli akademik sipas përcaktimeve ligjore dhe duhet të plotësojë kriteret e mëposhtme:
 - a) kandidati për drejtues vetëkandidohet dhe është personel akademik i kategorisë “Profesor” ose ka gradën shkencore “Doktor” (“PHD”), të fituar pranë universiteteve të vendeve anëtare të OECD-së ose BE-së. Në rastet kur nuk ka kandidatë të kësaj kategorie, mund të kandidojë për drejtues edhe lektori, kur ky i fundit mban gradën shkencore “Doktor”.
 - b) duhet të ketë përvojë në mësimdhënie për një periudhë jo më pak se 5 vjet dhe të jetë pjesë e personelit akademik me kohë të plotë;
 - c) të ketë veprimtari të spikatur akademike, kërkimore e shkencore të vazhdueshme
 - d) të mos jetë dënuar me një vendim të formës së prerë për vepra penale;
 - e) të mos ketë masë disiplinore në fuqi;
 - f) të mos ketë papajtueshmëri në kuptim të ligjit nr. 45/2015 "Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë" dhe ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".
2. Drejtuesi i njësisë bazë ushtron këto funksione:
 - a. përfaqëson njësinë bazë në organet e UV-së dhe në marrëdhënie me të tretët për çështjet akademike dhe protokollare;
 - b. drejton dhe kontrollon veprimtarinë e njësisë bazë për çështjet akademike dhe protokollare;
 - c. përgjigjet për zbatimin e akteve ligjore e nënligjore, të statutit dhe të rregulloreve të UV-së në njësinë bazë.
 - d. i përcjell drejtuesit të njësisë kryesore propozimin e njësisë për programet e reja të studimit;
 - e. i përcjell drejtuesit të njësisë kryesore propozimin e njësisë për kriteret e pranimit të studentëve për secilin program studimi që ofron njësia bazë;
 - f. i përcjell drejtuesit të njësisë kryesore propozimin e njësisë për numrin e studentëve për çdo program studimi që ofron njësia bazë;
 - g. i përcjell drejtuesit të njësisë kryesore propozimin e njësisë bazë për kriteret e rekrutimit për personelin akademik dhe të personelit ndihmës akademik që ka në shërbim;
 - h. i përcjell drejtuesit të njësisë kryesore propozimin e njësisë bazë për miratimin e dhënies së vitit akademik sabatik të kërkuar nga personeli akademik i njësisë bazë, që i përket kategorisë “Lektor” dhe “Profesor”;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI “ISMAIL QEMALI” VLORE
SENATI AKADEMIK**

- i. i përcjell drejtuesit të njësisë kryesore propozimin e njësisë bazë për personelin akademik të ftuar që do të kërkohet të punësohet me kontratë për periudha të shkurtra kohore;
 - j. krijon dhe drejton komisionin përgjegjës për procesin e përzgjedhjes së kandidatëve për studentë fitues dhe miraton listën e fituesve;
 - k. përcakton ngarkesën mësimore për personelin akademik të njësisë bazë, pasi ka marrë mendimin e anëtarëve të njësisë bazë dhe ia përcjell drejtuesit të njësisë kryesore për miratim;
 - l. i propozon dekanit për miratim përgjegjësit e grupeve mësimore dhe kërkimore-shkencore, nga kategoria e personelit akademik “Profesor” ose grada shkencore “Doktor”.
 - m. i propozon drejtuesit të njësisë kryesore përbërjen e komisioneve të provimeve të formimit, të mbrojtjes së diplomave.
 - n. ngre komisionin, që do të realizojë procedurat për njohjen dhe njësimin e periudhave të studimit për të gjitha rastet e përcaktuara në ligj dhe aktet e tjera nënligjore (rifillim studimesh, transferim studimesh, programe të dyta etj.);
 - o. Përcakton përfaqësuesit e njësisë bazë anëtare në komisionin *ad hoc* për konkursin e rekrutimit të personelit akademik me kohë të plotë dhe me kohë të pjesshme për njësinë bazë dhe ia përcjell për miratim drejtuesit të njësisë kryesore.
 - p. përcakton përfaqësuesit e njësisë bazë anëtare në komisionin *ad hoc* për konkursin e rekrutimit të personelit ndihmësakademik, në shërbim të njësisë bazë dhe ia përcjell për miratim drejtuesit të njësisë kryesore.
 - q. miraton paraprakisht kërkesën e personelit akademik me kohë të plotë të njësisë bazë, për t'u angazhuar me kohë të pjesshme në një institucion tjetër të arsimit të lartë.
 - r. harton planin strategjik të zhvillimit të njësisë bazë pasi ka marrë mendimin e anëtarëve të njësisë bazë dhe ia përcjell drejtuesit të njësisë kryesore.
3. Drejtuesi i njësisë bazë në ushtrim të kompetencave të tij, shprehet me urdhëra dhe akte të tjera sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 39

Mbarimi i mandatit të Drejtuesit të njësisë bazë

Mandati i Drejtuesit të njësisë bazë mbaron kur:

- a) përfundon afati i mandatit;
- b) jep dorëheqjen;
- c) në rastet e parashikuara në ligjin nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”;
- d) është në kushtet e pamundësisë për të kryer detyrën;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI “ISMAIL QEMALI” VLORE
SENATI AKADEMIK

e) nuk jeton më.

Neni 40

Administratori i Universitetit

1. Administratori është autoriteti më i lartë administrativ dhe përgjegjës për mirëfunksionimin financiar të institucionit. Ai është përfaqësues ligjor i institucionit të arsimit të lartë për çështjet financiare dhe administrative.
2. Administratori përzgjidhet me konkurs të hapur, sipas kriterëve të përcaktuara nga Bordi i Administrimit. Lista e kandidatëve që plotësojnë kriteret miratohet nga Senati Akademik. Emërimi i administratorit bëhet nga Bordi i Administrimit.
3. Administratori i institucionit, përveç sa parashikohet në nenin 52 të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, ka dhe këto kompetenca:
 - a) harton projektbuxhetin vjetor, mbi bazën e propozimeve të njësive kryesore dhe bazë, mbështetur në planin strategjik të zhvillimit të institucionit dhe në planin buxhetor afatmesëm të tij;
 - b) propozon kriteret për administrimin e burimeve financiare e materiale, të cilat ia paraqet për miratim Bordit të Administrimit dhe mbikëqyr shpërndarjen e zbatimit të tyre;
 - c) ndjek dhe kontrollon zbatimin e buxhetit vjetor të institucionit të arsimit të lartë në strukturat e varësisë së tij;
 - ç) zbaton të gjitha vendimet e Bordit të Administrimit dhe të Senatit Akademik me karakter financiar dhe administrativ;
 - d) i paraqet Bordit të Administrimit dhe Senatit Akademik raportin mbi veprimtarinë financiare të institucionit të arsimit të lartë, në përfundim të vitit akademik;
 - dh) bashkëpunon me strukturat dhe autoritetet e tjera të institucionit të arsimit të lartë për çështje të administrimit të përditshëm;
 - e) në cilësinë e punëdhënësit të personelit administrativ i propozon Bordit të Administrimit kriteret dhe procedurat e punësimit si dhe ushtron të drejtën e dhënies së masave disiplinore ndaj personelit administrativ;
 - ë) urdhëron ngritjen e komisionit *ad hoc* për konkursin e rekrutimit të personelit administrativ, sipas përcaktimeve në këtë Statut;
 - f) emëron dhe shkarkon administratorët e njësive kryesore dhe njësive bazë pas miratimit të Bordit të Administrimit;
 - g) me kërkesën e SA-së, informon këtë të fundit për çështjet e përmbushjes së nevojave akademike;
 - gj) plotëson kërkesat e Rektorit, me qëllim përmbushjen e nevojave akademike, administrative dhe financiare;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK**

- h) pas përfundimit të afateve ligjore emëron dhe nënshkruan kontratën e punës me personelin administrativ të UV- së.
 - i) urdhëron largimin nga detyra dhe zgjidhjen e menjëhershme të marrdhënies së punës me personelin administrativ të UV-së sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.
4. Bordi i Administrimit shkarkon administratorin me 2/3 (dy të tretat) e votave të anëtarëve të tij.

Neni 41

Administratori i njësisë kryesore

1. Administratori i njësisë kryesore është përgjegjës për mirëfunksionimin financiar dhe administrativ të saj.
2. Administratori i njësisë kryesore zgjidhet me konkurs, sipas procedurave dhe kritereve të përcaktuara nga Bordi i Administrimit. Ai emërohet dhe shkarkohet nga administratori i institucionit pas miratimit paraprak të Bordit të Administrimit.
3. Administratori i njësisë kryesore duhet të ketë formim universitar, së paku në nivelin "Master i shkencave" në fushën e drejtësisë ose ekonomisë dhe përvojë pune, së paku pesë vjet në këto fusha.
4. Administratori i njësisë kryesore nuk mund të ushtrojë asnjë funksion tjetër, akademik apo administrativ.
5. Administratori i njësisë kryesore i raporton për veprimtarinë e tij administratorit të institucionit të arsimit të lartë, si dhe informon drejtuesin e njësisë kryesore, periodikisht ose me kërkesë.
6. Administratori i njësisë kryesore i propozon administratorit të institucionit shkarkimin e administratorëve të njësive bazë.
7. Funksione të tjera të administratorit të njësisë kryesore, përveç sa parashikohet nga ligji për arsimin e lartë, përcaktohen në Rregulloren e institucionit.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

KREU V
PERSONELI I INSTITUCIONIT

Neni 42
Struktura dhe organika

1. Senati Akademik në bazë të propozimit të Rektoratit harton strukturën organike për të gjitha nivelet dhe i propozon Bordit të Administrimit miratimin e numrit të përgjithshëm të personelit.

Neni 43
Personeli i UV-së

1. Personeli në UV përbëhet nga personeli akademik, personeli ndihmësakademik dhe personeli administrativ.
2. Personeli në UV është i punësuar me kontratë, me kohëzgjatje të pacaktuar ose të caktuar, si edhe me angazhim me kohë të plotë ose me kohë të pjesshme, sipas Rregullores së UV-së për lidhjen e kontratave me punonjësit.
3. Ata zhvillojnë veprimtarinë e tyre në përputhje me ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën Shqipërisë", aktet e tjera ligjore e nënligjore në fuqi, Statutin, rregulloret e universitetit dhe të njësive kryesore, dhe aktet e tjera të brendshme të UV-së.
4. Të drejtat dhe detyrimet e personelit në UV përcaktohen në këtë Statut, në rregulloret e akte të tjera të brendshme të universitetit dhe/apo njësisë kryesore, si dhe në kontratat individuale të punës, në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Neni 44
Personeli akademik

1. Personeli akademik në UV kryen veprimtari të mësimdhënies, të kërkimit shkencor, shërbime për mbështetje dhe zhvillim të UV-së, këshillim për studentët, konsulencë e trajnime për të tretët, si dhe veprimtari të tjera.
2. Personeli akademik në UV është me orientim mësimor dhe/ose kërkimor-shkencor. Njësitë bazë dhe kryesore kanë detyrimin që të bëjnë këtë klasifikim për UV-në dhe ta rinovojnë atë në mënyrë periodike.
3. Personeli akademik në UV, sipas rolit dhe veprimtarisë që kryen, kategorizohet në:
 - a) profesorë;
 - b) lektorë;
 - c) asistent-lektorë.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

4. Në kategorinë "Profesorë" përfshihen anëtarët e personelit akademik, titullarë të lëndëve ose moduleve dhe udhëheqës të veprimtarisë kërkimore-shkencore. Anëtarët e personelit akademik të kësaj kategorie mbajnë titujt akademikë "Profesor" ose "Profesor i asociuar". Kjo kategori punësohet me kontratë me kohëzgjatje të pacaktuar.
5. Në kategorinë "Lektorë" përfshihen anëtarët e personelit akademik, që zhvillojnë veprimtari mësimore dhe kërkimore-shkencore. Në këtë kategori përfshihen anëtarët e personelit akademik, që mbajnë gradën shkencore "Doktor", kanë së paku tre vite eksperiencë në mësimdhënie para ose pas fitimit të kësaj grade shkencore. Kjo kategori punësohet me kontratë me kohëzgjatje të pacaktuar.
6. Në kategorinë "Asistent-lektorë" përfshihen anëtarët e personelit akademik që zhvillojnë veprimtari mësimore-kërkimore. Asistent-lektorët duhet të kenë së paku diplomën "Master i shkencave". Asistent-lektori punësohet me kontratë me kohëzgjatje të caktuar.
7. Personeli akademik, që angazhohet në mësimdhënie, duhet të ketë së paku kualifikim të ciklit pasardhës. Ngarkesa e plotë mësimore për personelin akademik përcaktohet nga strukturat përgjegjëse në përputhje me udhëzimin përkatës të ministrit përgjegjës për arsimin.
8. Punësimi i personelit akademik me kohë të plotë bëhet me konkurs në bazë të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi:
 - a. Kriteret e punësimit të personelit akademik me kohë të plotë, përcaktohen nga njësia bazë, bazuar në nevojat e kësaj të fundit, miratohen nga rektori dhe publikohen në faqen web të UV-së.
 - b. Rektori krijon komisionin *ad hoc* për rekrutimin e personelit akademik me kohë të plotë me shumicë nga njësia bazë. Komisioni *ad-hoc* përbëhet nga pesë anëtarë: tre përfaqësues nga departamenti që kërkon të punësojë, një përfaqësues i njësisë kryesore dhe një përfaqësues i propozuar nga rektori/punëdhënësi.
 - c. Komisioni *ad hoc* vlerëson dhe rendit kandidatët konkurrues sipas pikëzimit të vendosur në rregulloren, e UV-së dhe ia përcjell rektorit i cili vendos në mënyrë përfundimtare mbi secilën kandidaturë.
 - d. Ankesat në lidhje me vlerësimin e kandidatëve dhe zbatimin e procedurave nga komisioni *ad hoc*, paraqiten tek rektori brenda 5 (pesë) ditëve. Kandidatit i lind e drejta e ankimit nga e nesërmja e njoftimit për fazën e parë të vlerësimit të dokumentacionit të dorëzuar. Në këtë rast, rektori urdhëron komisionin *ad-hoc* për pezullimin e procedurës së konkursit deri në përfundimin e procedurës së shqyrtimit të ankimit. Kur vlerëson se ankimi është i pranueshëm, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga e nesërmja e njoftimit të ankimit, rektori vendos me një akt të ri anulimin, shfuqizimin ose ndryshimin e vendimit të komisionit *ad-hoc*. Vendimi i rektorit i njoftohet komisionit *ad-hoc* i cili në vijim cakton datën dhe njofton kandidatët fitues për zhvillimin e intervistës me gojë. Kundër vendimit të fazës së dytë për vlerësimin e intervistës, kandidati ka të drejtën e ankimit brenda 5 (pesë) ditëve, duke filluar ky afat nga e nesërmja e njoftimit të këtij vendimi. Në këtë rast, rektori urdhëron



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

- shqyrtimin e ankimit. Kur vlerëson se ankimi është i pranueshëm, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga e nesërmja e njoftimit të ankimit, rektori vendos me një akt të ri anulimin, shfuqizimin ose ndryshimin e vendimit të komisionit *ad-hoc*.
- e. Vendimi përfundimtar i Rektorit për miratimin e klasifikimit përfundimtar dhe shpalljen e fituesit, i njoftohet palëve të interesuara.
 - f. Rektori emëron kandidatin fitues dhe nënshkruan kontratën e punës.
 - g. Modalitetet e tjera të punësimit përcaktohen në rregulloren e UV-së.
9. Punësimi i personelit akademik me kohë të pjesshme bëhet në bazë të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi:
- a. Njësitë kryesore, me propozim të njëjësive bazë, përcaktojnë në bazë të nevojave të tyre kërkesën për personel akademik me kohë të pjesshme. Ky propozim mund të realizohet vetëm nëse ngarkesa mësimore nuk plotësohet me personelin akademik me kohë të plotë. Rektori, në varësi të kërkesave dhe fondit të miratuar për këtë qëllim, miraton çdo vit listën emërore të personelit akademik me kontratë të pjesshme.
 - b. Ky personel duhet të përmbushë kriteret dhe kërkesat e përcaktuara nga njësia bazë. Rregullat më të hollësishme mbi mënyrën e konkurimit për personelin akademik me kontratë me kohë të pjesshme përcaktohen në rregulloren e brendshme të UV-së.
10. Kohëzgjatja e punësimit të personelit akademik:
- a. Personeli akademik, që mban titullin "Profesor", shërben në detyrë deri në moshën 68 vjeç, me përjashtim të rastit kur, me kërkesën e tij, largohet nga detyra. Mbështetur mbi nevojat e institucionit të arsimit të lartë dhe me pëlqimin e tij, ai mund të shërbejë në detyrë edhe pas moshës së lartpërmendur, përmes kontratave me kohëzgjatje deri në një vit, të përsëritshme. Drejtuesi i njësisë bazë ku ai kryen veprimtarinë e tij, me miratimin edhe të drejtuesit të njësisë kryesore, i drejton rektorit propozimin për të mbajtur në detyrë personelin e sipërpërmendur, duke argumentuar dhe nevojën e njëjësive bazë në këtë drejtim.
 - b. Personeli akademik, që mban titullin "Profesor i asociuar", shërben në detyrë deri në moshën 65 vjeç. Mbështetur mbi nevojat e institucionit të arsimit të lartë dhe me pëlqimin e tij, ai mund të shërbejë në detyrë edhe pas moshës së lartpërmendur, përmes kontratave me kohëzgjatje deri në një vit, të përsëritshme. Drejtuesi i njësisë bazë ku ai kryen veprimtarinë e tij, me miratimin edhe të drejtuesit të njësisë kryesore, i drejton rektorit propozimin për të mbajtur në detyrë personelin e sipërpërmendur, duke argumentuar dhe nevojën e njësisë bazë në këtë drejtim.
 - c. Personeli akademik, sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi, mund të shkëputet përkohësisht nga institucioni i arsimit të lartë, për një periudhë maksimale prej pesë vjetësh, për t'u angazhuar në detyra të rëndësishme shtetërore dhe politike. Për periudhën e shkëputjes mund të zëvendësohet nga personel akademik i punësuar me kontratë me afat të caktuar. Pas përfundimit të detyrës, me kërkesë të tij, anëtar i personelit akademik rikthehet në vendin e mëparshëm të punës ose në një vend të barasvlershëm.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK**

11. Fitimi i titujve akademikë në UV:

- a. Për fitimin e titullit "Profesor i asociuar" mund të aplikojë personeli akademik që gëzon gradën shkencore "Doktor", prej së paku pesë vitesh, është personel akademik i kategorisë "Lektor" dhe përmbush standardet shtetërore për fitimin e titullit. Për fitimin e titullit "Profesor" mund të aplikojë personeli akademik që gëzon prej së paku pesë vjetësh titullin "Profesor i asociuar", si dhe përmbush standardet shtetërore për fitimin e titullit.
- b. Kandidati për fitimin e titullit "Profesor i asociuar" ose "Profesor" paraqet dosjen pranë drejtuesit të njësisë kryesore. Dosja e kandidatit i përcillet senatit akademik, pas paraqitjes dhe vlerësimit në njësinë bazë. Senati i kalon dosjen Komisionit të Përhershëm për Promovimin e Personelit Akademik, i cili merr vendimin përfundimtar pas vendimit të jurisë mbi përmbushjen e standardeve. Titulli regjistrohet në regjistrin shtetëror të gradave shkencore dhe titujve akademikë pranë ministrisë përgjegjëse për arsimin. Titulli akademik lëshohet nga institucioni dhe firmoset nga rektori.
- c. Në rast vlerësimi negativ të kërkesës për fitimin e titujve akademikë nga Komisioni i Përhershëm për Promovimin e Personelit Akademik, kandidatit i lind e drejta të ripërsërisë kërkesën pas një periudhe kohore jo më të shkurtër se dy vjet.
- d. Personelit akademik, që mban titullin "Profesor", pas daljes në pension, në vlerësim të veprimtarisë së spikatur akademike, me propozim të njësisë bazë ku ka zhvilluar karrierën e tij dhe me vendim të Senatit Akademik, i akordohet titulli "Profesor emeritus".

Neni 45

Statusi dhe trajtimi i veçantë i personelit akademik

Statusi dhe trajtimi i veçantë i Personelit Akademik zbatohet sipas akteve nënligjore dhe udhëzimeve në fuqi të Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve.

Neni 46

Të drejtat, detyrat dhe përgjegjësitë e personelit akademik

1. Personeli akademik i UV-së ka këto të drejta:
 - a. të përparojë në karrierën akademike, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi;
 - b. të trajnohet, të kualifikohet në institucionet akademike e kërkimore shkencore, brenda dhe jashtë vendit, sipas legjislacionit në fuqi dhe në përputhje me profilin;
 - c. të zgjedhë dhe të zgjidhet në organet e UV-së, duke kryer veprimtari zgjedhore në përputhje me statutin dhe rregulloret e tjera të institucionit.
2. Personeli akademik i UV-së ka këto detyra dhe përgjegjësi:



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK**

- a. të njohë, të respektojë, të zbatojë dhe të veprojë në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi;
- b. të respektojë kohën në funksion të mësimdhënies dhe të kërkimit shkencor, sipas orarit të punës dhe ta shfrytëzojë vetëm për kryerjen e detyrave. Koha e punës dhe e mësimdhënies përcaktohet nëpërmjet kontratës së punës;
- c. të rrisë aftësitë profesionale akademike dhe të marrë pjesë në veprimtari formuese për këtë qëllim;
- d. të mos kërkojë ose pranojë asnjë përfitim pasuror, për kryerjen e detyrave akademike, me përjashtim të pagës dhe privilegjeve të tjera, të përcaktuara me ligj, akte nënligjore dhe aktet e brendshme të UV-së;
- e. të mbajë përgjegjësi të plotë për veprimet e tij, gjatë kryerjes së detyrës si personel akademik në UV;
- f. të zbatojë etikën institucionale në respektim të imazhit të institucionit dhe figurës profesionale;
- g. të zbatojë kodin e etikës në veshje e sjellje, gjatë kohës së ushtrimit të veprimtarisë akademike;
- h. të drejta dhe detyrime të tjera të personelit akademik përcaktohen në rregulloren e institucionit.

Neni 47

Personeli akademik i ftuar

1. Njësia bazë ka të drejtë të kërkojë të punësohen me kontratë për periudha të shkurtra kohe studiues, personalitete, artistë vendas ose të huaj për qëllime akademike dhe kërkimore shkencore që të kontribuojnë për periudha të shkurtra kohe. Personeli i ftuar përbëhet nga punonjës me tituj shkencorë.
2. Përzgjedhja e personelit akademik të ftuar bëhet nga njësia kryesore mbi bazën e propozimeve të njësive bazë, pasi të jenë identifikuar modulet ku do të angazhohen, vëllimi i orëve mësimore (leksione/ seminare, laboratore etj.) që ata do të kryejnë, si dhe kualifikimi i kandidatëve.
3. Kontrata e punës e personelit akademik të ftuar bëhet nga Rektori i UV-së.
4. Shpenzimet për personelin akademik të ftuar përballohen nga të ardhurat e Universitetit.

Neni 48

Viti akademik sabatik

1. Personeli akademik i kategorisë "Lektor" dhe "Profesor", me miratim të njësisë bazë ku zhvillon veprimtarinë akademike, ka të drejtë të shkëputet nga angazhimet e institucionit, një herë në shtatë vjet, për periudha kohe deri në një vit, për të punuar për përparimin e tij akademik.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

2. Për të përfituar nga parashikimi i pikës 1, anëtari personelit akademik duhet të paraqesë në departament kërkesën e tij të shoqëruar me propozimin përkatës për kërkimin shkencor që do të realizojë, vendin ku do ta ushtrojë këtë kërkim, nëse ka, kohën e nevojshme që i duhet, si edhe produktin që do të dorëzojë në fund të kësaj periudhe. Departamenti shpreh miratimin e tij dhe njofton drejtuesin e njësisë kryesore dhe Rektorin e UV-së.
3. Nëse kërkohet edhe mbështetje financiare në përputhje me zërat buxhetorë të miratuar nga Bordi i Administrimit për këtë qëllim, propozimi i kalon edhe Bordit të Administrimit për miratimin e pjesës financiare.
4. Kërkesa, në çdo rast duhet që të paraqitet dy muaj përpara fillimit të vitit akademik sabatik.
5. Gjatë vitit akademik sabatik, anëtari i personelit akademik paguhet me 100 për qind të pagës.
6. Midis personelit akademik dhe rektorit të Universitetit "Ismael Qemali" nënshkruhet një kontratë ku rregullohen kohëzgjatja, të drejtat dhe detyrimet, si dhe efektet financiare.
7. Gjatë kësaj periudhe, personelit akademik nuk i ngarkohet detyrë mësimdhënieje.
8. Personeli akademik mund të ndjekë gjatë këtij viti kurse specializimi jashtë institucionit.
9. Mosrealizimi i kërkimit shkencor, sipas programit të miratuar, përbën shkak për përgjegjësi disiplinore, si dhe detyron të rimbursojë të gjitha përfimet financiare që ka marrë.
10. Mënyra e kontrollit të cilësisë së produktit që duhet të realizohet gjatë vitit sabatik, bëhet në përputhje me parashikimet e rregullores së njësisë kryesore, sipas kontratës së nënshkruar.

Neni 49

Personeli ndihmësakademik

1. Personeli ndihmësakademik ndahet në personel ndihmësakademik me karakter mësimor-shkencor dhe ndihmësakademik me karakter administrativ.
2. Personeli ndihmësakademik me karakter mësimor-shkencor ndihmon në realizimin dhe mbështetjen e veprimtarive të mësimdhënies dhe/ ose të kërkimit shkencor. Ai është pjesë e njësisë bazë dhe shërben për mbështetjen e veprimtarive të kësaj të fundit. Në këtë kategori hyjnë laborantët dhe teknikët, si dhe personel tjetër, sipas përcaktimeve të bëra në aktet e brendshme të institucionit.
3. Personeli ndihmësakademik me karakter administrativ ndihmon në realizimin dhe mbështetjen e veprimtarive të mësimdhënies dhe/ose të zhvillimit të institucionit të arsimit të lartë në nivel njësie bazë, njësie kryesore ose në nivel institucional. Në këtë kategori bëjnë pjesë personeli i punësuar në strukturat ndihmësakademike pranë Rektoratit, pranë njësisë kryesore dhe njësisë bazë (psh. sekretari i departamentit) sipas përcaktimeve të këtij statuti dhe rregullores së Brendshme të UV-së.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK**

Neni 50

Personeli administrativ

Strukturat administrative në nivel institucioni janë:

- a. Bordi i Administrimit
- b. Administratori
- c. Strukturat e auditimit të brendshëm
- ç. Strukturat ekonomike
- d. Strukturat e investimeve
- dh. Strukturat e prokurimeve
- e. Strukturat e shërbimeve

Neni 51

Punësimi i personelit ndihmësakademik

1. Punësimi i personelit ndihmësakademik në UV bëhet me konkurs publik.
2. Punësimi do të realizohet sipas kritereve dhe procedurave të përcaktuara në Rregulloren e UV-së.
3. Komisioni *ad hoc* vlerëson dhe rendit kandidatët konkurues sipas pikëzimit të vendosur në Rregulloren e UV-së.
4. Komisioni *ad hoc* i propozon për miratim rektorit renditjen përfundimtare,
5. Ankesat në lidhje me vlerësimin e kandidatëve dhe zbatimin e procedurave nga komisioni *ad hoc*, paraqiten brenda 5 (pesë) ditëve tek Rektori. Në rast të konstatimit të parregullsive në zbatimin e procedurave, Rektori vendos për pavlefshmërinë e procesit dhe ripërsëritjen e tij.
6. Rektori miraton klasifikimin përfundimtar dhe shpall fituesin e procedurës.
7. Rektori emëron kandidatin fitues dhe nënshkruan kontratën e punës.
8. Modalitete e tjera të punësimit përcaktohen në rregullore e brendshme të UV-së.

Neni 52

Punësimi i personelit administrativ

1. Kategoritë e personelit administrativ dhe nivelet e pagave miratohen nga Bordi i Administrimit konform akteve ligjore në fuqi.
 2. Punësimi i personelit administrativ në UV bëhet me konkurs publik.
 3. Punësimi do të realizohet sipas kritereve dhe procedurave të propozuara nga administratori dhe të miratuara nga Bordi i Administrimit të UV-së.
 4. Në përfundim të procedurave të punësimit, kontrata e punësimit do të nënshkruhet nga Administratori i institucionit.
 5. Modalitete e tjera të punësimit të personelit administrativ përcaktohen në rregullore e brendshme të UV-së.
-



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI “ISMAIL QEMALI” VLORE
SENATI AKADEMIK**

Neni 53

Masat disiplinore

1. Masat disiplinore, të parashikuara në Statut merren kur personeli i Universitetit “Ismael Qemali”, Vlorë është përgjegjës për shkeljen me faj të detyrimeve:
 - a. mospërbushje të detyrimeve kontraktuale;
 - b. përfitim në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë të dhuratave, favoreve, premtimeve ose trajtimeve preferenciale, të cilat jepen për shkak të detyrës;
 - c. shkelje të përsëritur e kodit të etikës në institucion
 - d. shkelje të akteve ligjore në fuqi.
2. Lloji i masës disiplinore të dhënë duhet të justifikohet me llojin e shkeljes së kryer dhe pasojave të sjella.
3. Llojet e masave disiplinore janë:
 - a. tërheqje vëmendje;
 - b. vërejtje me shkrim;
 - c. vërejtje me paralajmërim për largim nga detyra;
 - d. pezullim nga detyra;
 - e. largim nga detyra.

Neni 54

Procedura për dhënien e masave disiplinore

1. Masat disiplinore për personelin akademik jepen nga autoritetet drejtuese akademike, me përjashtim të largimit nga detyra që është kompetencë vetëm e Rektorit.
2. Largimi nga detyra i personelit akademik të UV-së bëhet nga Rektori, me propozimin e drejtuesit të njësisë bazë, ku personeli akademik zhvillon veprimtarinë e tij dhe, pas miratimit të komisionit *ad hoc*, të ngritur nga Senati Akademik, në rastet e shkeljeve të rënda dhe të përsëritura të ligjit.
3. Në shkelje të rënda të ligjit përfshihen:
 - a. Veprimet apo mosveprimet, e përsëritura, në kundërshtim me ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe/apo aktet nënligjore në fuqi për arsimin e lartë;
 - b. Veprimet apo mosveprimet, e përsëritura, në kundërshtim me ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;
 - c. Veprimet apo mosveprimet, e përsëritura, në kundërshtim me akte të tjera ligjore e nënligjore në fuqi në Republikën e Shqipërisë, të detyrueshme për zbatim gjatë kryerjes së detyrës;
 - d. Kryerja e një vepre penale, për të cilën dënohet me vendim gjyqësor të formës së prerë.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI “ISMAIL QEMALI” VLORE
SENATI AKADEMIK

4. Rastet e tjera të shkeljeve, lloji i masës disiplinore për secilën shkelje dhe organi që i jep ato, përcaktohen në Rregulloren e Universitetit.
5. Për personelin administrativ dhe ndihmësakademik procedurat për masat disiplinore përcaktohen në Rregulloren e UV-së.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI “ISMAIL QEMALI” VLORE
SENATI AKADEMIK**

**KREU VI
ORGANIZIMI I STUDIMEVE**

**Neni 55
Format e studimeve universitare**

1. Universiteti “Ismail Qemali”, Vlorë ofron këto forma studimi:
 - a) studime me kohë të plotë;
 - b) studime me kohë të zgjatur.
2. Studimet me kohë të zgjatur ofrohen në programet e studimit një deri në dyvjeçare me karakter profesional, programet e ciklit të dytë “Master profesional” dhe programet e ciklit të tretë “Master ekzekutiv”.
3. Programet e studimit, që japin të drejtën e ushtrimit të një profesioni të rregulluar, organizohen vetëm në formën e studimeve me kohë të plotë.

**Neni 56
Ciklet dhe programet e studimit**

1. Programet e studimit në Universitetin “Ismail Qemali”, Vlorë organizohen në tri cikle të njëpasnjëshme studimi:
 - a) cikli i parë;
 - b) cikli i dytë;
 - c) cikli i tretë;referuar niveleve 6, 7, 8 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve.
2. Universiteti “Ismail Qemali”, Vlorë ofron diploma profesionale referuar nivelit 5 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve. Programet e studimeve hartohen nga njësitë bazë dhe i kalojnë për miratim Senatit Akademik, Bordit të Administrimit dhe aprovim në Ministrinë përgjegjëse të Arsimit.
3. Programet e miratuara nga Senati Akademik i propozohen ministrisë përgjegjëse për arsimin e lartë, e cila miraton hapjen e programeve të studimit. Programet e miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin e lartë, shpallen publikisht nga Universiteti “Ismail Qemali”, Vlorë përpara fillimit të aplikimeve për pranime.
4. Në Universitetin “Ismail Qemali”, Vlorë programet e studimeve të ciklit të parë hartohen dhe propozohen nga njësitë bazë, sipas nevojave dhe specifikës së çdo fushe përkatëse. Njësitë bazë hartojnë programe studimore për çdo lëndë që përfshihet në fushën e departamentit. Projektprogramet e përgatitura nga njësitë bazë duhet të respektojnë standardet e kërkuara.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI “ISMAIL QEMALI” VLORE
SENATI AKADEMIK**

5. Propozimet lidhur me programet shqyrtohen dhe marrin një miratim paraprak nga Komisioni i Sigurimit të Cilësisë së Brendshme të Fakultetit (KSCBF) dhe i përcillen Senatit Akademik për miratim.
6. Në rast mosmiratimi njësia bazë, brenda tridhjetë ditëve, mund të paraqesë një propozim të ri i cili merr parasysh arsyet e mosmiratimit të Senatit Akademik. Në rast se, edhe pas propozimit të ri të programit nga njësia bazë, Senati Akademik nuk e miraton, atëherë programi quhet përfundimisht i pamiratu.
7. Universiteti “Ismail Qemali”, Vlorë mund të ofrojë programe studimi në një nga gjuhët zyrtare të Bashkimit Evropian: anglisht, frëngjisht, gjermanisht, spanjisht dhe italisht. Studentët, që ndjekin këto programe studimi, duhet të dëshmojnë njohjen e gjuhës së huaj përkatëse në nivelin e përcaktuar në Rregulloren e Universitetit.

Neni 57

Programet e ciklit të parë të studimeve

1. Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë të japin njohuri bazë mbi metoda e parime shkencore të përgjithshme dhe aftësi specifike në një varietet të gjerë profesionale dhe specialitetesh. Programet e ciklit të parë realizohen me 180 kredite evropiane (ECTS) dhe kohëzgjatja normale e tyre është tri vite akademike.
2. Sasia normale e krediteve të grumbulluara gjatë një viti akademik nga një student është 60 kredite.
3. Studentët e Universitetit të Vlorës në përfundim të programit të ciklit të parë të studimeve, diplomohen me provim të përgjithshëm përfundimtar ose me punim diplome.
4. Pragu i notës mesatare për zhvillimin e punimit të diplomës përcaktohet në Rregulloren e Universitetit “Ismail Qemali” të Vlorës dhe mund të ndryshojë vetëm me vendim të Senatit Akademik.
5. Në përfundim të programeve të studimeve të ciklit të parë lëshohet diplomë universitare “Bachelor” në fushën përkatëse të arsimimit të kryer.

Neni 58

Pranimi në ciklin e parë të studimit

1. Kanë të drejtë për t’u pranuar në programet e studimeve të ciklit të parë të Universitetit “Ismail Qemali”, Vlorë, kandidatët që plotësojnë kriteret e mëposhtme:
 - a) shtetasit shqiptarë që kanë përfunduar me sukses ciklin e arsimit të mesëm;
 - b) shtetasit shqiptarë që kanë një diplomë të shkollës së mesme ekuivalente të një vendi të huaj sipas përcaktimeve të akteve ligjore në fuqi;
 - c) shtetasit e huaj në kushtet dhe mënyrat e parashikuara nga marrëveshjet dypalëshe ose shumëpalëshe kundrejt pagimit të tarifës së caktuar.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

2. Pranimi në programet e studimit të ciklit të parë është i mundur për çdo kandidat që plotëson kriterin e notës mesatare të përcaktuar me vendim të Senatit Akademik të Universitetit të Vlorës, në përputhje me vendimet e Këshillit të Ministrave.
3. Brenda muajit prill të çdo viti, krahas propozimit të justifikuar për kuotat e pranimit, secili fakultet përgatit propozimin për kritere për përzgjedhjen e kandidatëve, për t'u pranuar në ciklin e parë të studimeve.
4. Kriteret shtesë propozohen nga njësia bazë dhe, pas miratimit nga Senati Akademik, i vihen në dispozicion Qendrës së Shërbimeve Arsimore dhe ministrisë përgjegjëse për arsimin. Këto kritere bëhen publikisht të njohura nga UV-ja, të paktën një vit para fillimit të pranimeve të radhës në institucion, së bashku me informacionin e nevojshëm mbi fakultetin përkatës dhe programet që ofron.
5. Në fillim të vitit akademik, Universiteti "Ismael Qemali", Vlorë dërgon në Qendrën e Shërbimeve Arsimore listën e studentëve të regjistruar.

Neni 59

Programet e ciklit të dytë të studimeve

1. Programet të ciklit të dytë të studimeve japin njohuri të thelluara, teorike dhe praktike, si dhe trajnim për kërkim të pavarur në një fushë brenda një specialiteti. Ato janë programe të studimeve "Master i shkencave" dhe "Master profesional".
2. Programet e studimit "Master i shkencave" pajisin të diplomuarit me njohuri të thelluara teorike, si dhe me aftësim për kërkim shkencor në një fushë të caktuar. Këto programe organizohen në:
 - a. programe që realizohen me jo më pak se 120 kredite formimi në vijim të ciklit të parë dhe me kohëzgjatje normale dy vite akademike;
 - b. programe të integruara të studimeve të ciklit të dytë, që realizohen me 300 dhe 360 kredite dhe me kohëzgjatje normale respektivisht pesë dhe gjashtë vite akademike.
3. Programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë ofrohen në fushën e drejtësisë dhe në fusha të tjera studimi të miratuara me vendim të Senatit Akademik.
4. Studimet e ciklit të dytë "Master i shkencave" përmbyllen me punim diplome dhe në përfundim të tyre lëshohet diplomë "Master i shkencave" në fushën e arsimimit të kryer.
5. Programet e studimeve "Master profesional" pajisin të diplomuarit me njohuri të thelluara, profesionale në një fushë të caktuar. Këto programe organizohen me 60 ose 120 kredite dhe kohëzgjatja normale e tyre është një vit ose dy vite akademike. Studimet e ciklit të dytë "Master profesional" përmbyllen me provim përfundimtar formimi ose punim diplome dhe në përfundim të tyre lëshohet diplomë "Master profesional" në fushën e arsimimit të kryer.
6. Programet e studimit në fushën e mësuesisë për arsim parashkollor dhe arsim fillor, organizohen në dy cikle: program i ciklit të parë "Bachelor", që formon mësues të arsimit



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
SENATI AKADEMIK

parashkollor dhe program i ciklit të dytë "Master profesional", që formon mësues të arsimit fillor.

- a. Programet e studimit për formimin e mësuesve të arsimit të mesëm të ulët dhe të lartë organizohen si programe të ciklit të dytë të studimeve "Master", me 120 kredite, sipas fushave përkatëse të formimit.
 - b. Programet e ciklit të dytë të studimit në fushën e mësuesisë duhet të përmbajnë 25 % të krediteve në shërbim të formimit të përgjithshëm psiko-pedagogjik.
 - c. Programet e ciklit të dytë të studimit, që formojnë mësues të së njëjtës fushë të mësuesisë, duhet të kenë së paku 80 % të kurrikulës me përmbajtje të ngjashme.
7. Programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë të studimeve në fushën e drejtësisë realizohen me 300 kredite, për një kohëzgjatje prej jo më pak se 5 vite akademike.

Neni 60

Pranimi në ciklin e dytë të studimit

1. Në Universitetin "Ismail Qemali", Vlorë, për pranim në programet e ciklit të dytë të studimeve, kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme:
 - a. të kenë përfunduar një program të ciklit të parë të studimeve dhe të zotërojnë një diplomë të këtij cikli ose diplomë tjetër studimi të fituar jashtë vendit, të vlerësuar ekuivalente me të;
 - b. të plotësojnë kriterin e mesatares së miratuar;
 - c. të plotësojnë standardet akademike të kriterëve shtesë të pranimi për çdo program.
2. Pranimi në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë është i mundur për kandidatët që plotësojnë kriteret e përcaktuara në pikën 1, të nenit 44, të këtij Statuti.
3. Në Universitetin "Ismail Qemali", Vlorë kriteret e pranimi të kandidatëve në programet e ciklit të dytë të studimeve përcaktohen nga njësia bazë ofruese e programit.
4. Kriter pranimi në një program studimi të ciklit të dytë "Master i shkencave" është njohja nga kandidati e një prej pesë gjuhëve të huaja të Bashkimit Evropian: anglisht, frëngjisht, gjermanisht, spanjisht dhe italisht. Nëse individ ka fituar një diplomë të një programi studimi të kryer në një nga këto gjuhë, diploma e fituar shërben si dëshmi për plotësimin e këtij kriteri.
5. Universiteti "Ismail Qemali", Vlorë njeh kreditet e përfituara në programet e studimit të ciklit të dytë "Master profesional", me qëllim transferimin e tyre në programet e studimit "Master i shkencave" në fusha të përafërta studimi. Njohja e krediteve bëhet sipas procedurës së përcaktuar në Rregulloren e Universitetit.
6. Në fillim të vitit akademik, Universiteti "Ismail Qemali", Vlorë dërgon në Qendrën e Shërbimeve Arsimore listën e studentëve të regjistruar.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI “ISMAIL QEMALI” VLORË SENATI AKADEMIK

Neni 61

Programet e ciklit të tretë të studimeve

1. Në Universitetin “Ismail Qemali”, Vlorë programet e ciklit të tretë janë studime në “Master ekzekutiv”, programet e studimeve specializuese afatgjata, si dhe studimet e doktoratës. Ato janë programe studimi me karakter plotësisht akademik, që kanë në bazë kërkimin shkencor dhe veprimtari krijuese të pavarura.
2. Programet e studimeve “Master ekzekutiv” ofrojnë arsimim të një niveli të lartë shkencor dhe profesional. Ato kanë kohëzgjatje normale një ose dy vite akademike dhe organizohen përkatësisht me 60 ose 120 kredite. Ato përmbyllen me punim diplome dhe në përfundim të tyre lëshohet diploma “Master ekzekutiv” në fushën e arsimimit të kryer.
3. Programet e studimeve specializuese afatgjata janë programe të formimit profesional, që ofrojnë njohuri për profesione të veçanta. Ato zgjasin jo më pak se dy vite akademike dhe organizohen me jo më pak se 120 kredite. Ato përmbyllen me provim formimi ose me punim diplome dhe në përfundim të tyre lëshohet “Diplomë specializimi” në fushën përkatëse të programit të studimit.
4. Studimet e doktoratës ndërtohen mbi programe individuale për aftësim të pavarur të kandidatëve në kërkimin shkencor në fushat e përcaktuara nga njësia bazë ose njësia kryesore. Ato kanë në themel kërkimin shkencor dhe veprimtaritë krijuese. Studimet e doktoratës zgjasin jo më pak se tri vite akademike dhe jo më shumë se pesë vite akademike. Në përfundim të studimeve të doktoratës lëshohet diploma e gradës shkencore “Doktor”.
5. Organizimi dhe funksionimi i programeve të studimeve të ciklit të tretë dhe kriteret për vlerësimin vjetor të ecures së kandidatëve dhe vazhdimin e punës për zhvillimin e projektit kërkimor, përcaktohen në Rregulloren e Universitetit “Ismail Qemali”, Vlorë dhe në rregulloret e programeve përkatëse.

Neni 62

Pranimi në ciklin e tretë të studimit

Në Universitetin “Ismail Qemali”, Vlorë pranimi në programet e ciklit të tretë të studimeve është i mundur për kandidatin që ka fituar diplomën “Master i shkencave” ose diplomë të integruar të studimeve të ciklit të dytë dhe plotëson këto kritere pranimi:

- a. të zotërojë diplomë të ciklit të dytë të studimeve “Master i shkencave”, diplomë të integruar të studimeve të ciklit të dytë ose çdo diplomë tjetër të vlerësuar të barazvlershme me të në fushën e programit të studimit apo në një fushë të përafërt me të, të përcaktuar më parë në rregulloren e programit përkatës të fushës së studimit. Diplomat e fituara jashtë vendit duhet të jenë të njohura dhe të njësuar nga organet kompetente;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
SENATI AKADEMIK

- b. të ketë notë mesatare të paktën 8 (tetë) në çdo diplomë që zotëron, të lëshuar nga IAL-të shqiptare apo të huaja. Senati Akademik ka të drejtë të vendosë kritere më të larta të mesatares në varësi të programit të doktoratës, duke konsideruar prioritarë kandidatët që janë anëtarë të personelit akademik të Universitetit;
- c. të zotërojnë një prej pesë gjuhëve të huaja të Bashkimit Evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht, spanjisht dhe italisht), e vërtetuar përmes testeve të njohura ndërkombëtare, në përputhje me udhëzimin përkatës të ministrit përgjegjës për arsimin e lartë. Nëse individi ka fituar një diplomë në një program studimi të kryer në një nga këto gjuhë, diploma e fituar shërben si dëshmi për plotësimin e këtij kriteri;
- d. të plotësojnë kritere të tjera shtesë të propozuara nga njësia bazë dhe të miratuara nga Senati Akademik.

Neni 63

Cikli i tretë i studimeve

1. Universiteti "Ismail Qemali", Vlorë ofron programe studimi të ciklit të tretë, studime të doktoratës. Programet e studimeve të doktoratës zhvillohen me kohë të plotë pranë njësisë/njërive bazë ose me kohë të zgjatur në ato raste kur doktoranti është i punësuar si personel akademik në një institucion tjetër të arsimit të lartë apo si personel kërkimor në një institucion të kërkimit bazë ose të zbatuar.
2. Universiteti "Ismail Qemali", Vlorë mund të ofrojë në bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë programe të studimit të doktoratës.
3. Njësitë bazë përcaktojnë projektin kërkimor dhe numrin e doktorantëve.
4. Në Universitetin "Ismail Qemali", Vlorë drejtuesit shkencorë të doktorantëve duhet të kenë titullin "Profesor" ose "Profesor i asociuar". Numri i udhëheqjeve shkencore të doktoratave për çdo titull përcaktohet në Kodin e Cilësisë së Arsimit të Lartë.
5. Universiteti "Ismail Qemali", Vlorë i përcjell listën e të diplomuarve ministrisë përgjegjëse për arsimin e lartë për t'u pasqyruar në regjistrin shtetëror të gradave shkencore dhe titujve akademikë.
6. Të dhëna më të hollësishme në lidhje me programet e ciklit të tretë të studimeve përcaktohen në Rregulloren e studimeve të doktoratës.

Neni 64

Programet e përbashkëta të studimit

1. Universiteti "Ismail Qemali", Vlorë mund të ofrojë programe të përbashkëta studimi, në bashkëpunim me një ose disa institucione të tjera të arsimit të lartë, publike ose jopublike, brenda ose jashtë vendit.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI “ISMAIL QEMALI” VLORE
SENATI AKADEMIK**

2. Këto programe mund të ofrohen me marrëveshje të përbashkët, në gjuhën shqipe ose në një nga gjuhët zyrtare të Bashkimit Evropian.
3. Në përfundim të studimeve lëshohet diplomë e përbashkët ose diplomë e dyfishtë ose e shumëfishtë nga institucionet pjesëmarrëse me të cilat Universiteti “Ismael Qemali”, Vlorë ka marrëveshje bashkëpunimi.
4. Hapja e programeve të përbashkëta të studimit bëhet me miratimin e ministrit të arsimit dhe sportit.

Neni 65

Programet e studimeve të formimit të vazhduar

1. Universiteti “Ismael Qemali”, Vlorë ofron programe të studimeve të formimit të vazhduar, si formë e të mësuarit gjatë të gjithë jetës. Këto programe shërbejnë për plotësim, thellim dhe konsolidim të njohurive dhe mund të ofrohen si kurse kualifikimi e rikualifikimi, shkolla verore dhe veprimtari të ngjashme.
2. Njësitë bazë në bashkëpunim me ministrinë e arsimit dhe sportit përcaktojnë strukturën e programeve, kohëzgjatjen dhe kreditet e tyre.
3. Universiteti “Ismael Qemali”, Vlorë lëshon certifikata përkatëse në përfundim të programeve të studimeve të formimit të vazhduar.
4. Universiteti “Ismael Qemali”, Vlorë mund të ofrojë kurse përgatitore për programet e studimeve që organizon.

Neni 66

Ndjekja e një programi të dytë studimi

1. Në Universitetin “Ismael Qemali”, Vlorë individët që kanë përfunduar një program studimi, kanë të drejtë të ndjekin një program të dytë studimi të të njëjtit cikël. Në këtë rast, si rregull, përzgjidhen kandidatët që kanë mesataren më të lartë.
2. Kriteret e tjera specifike për ndjekjen e një programi të dytë studimi të të njëjtit cikël përcaktohen nga njësitë bazë.
3. Kandidatët, të cilët pranohen në një program të dytë studimi, përballojnë koston e plotë të studimeve. Nga ky rregull përjashtohen studentët e shkëlqyer.

Neni 67

Viti akademik dhe organizimi i mësimdhënies

1. Studimet në Universitetin “Ismael Qemali”, Vlorë zhvillohen në vite akademike. Data zyrtare e fillimit të vitit akademik shpallet nga ministri i arsimit dhe sportit për arsimin e lartë. Viti akademik organizohet në tre semestra:
 - a) semestri i vjeshtës;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI “ISMAIL QEMALI” VLORË
SENATI AKADEMIK

- b) semestri i pranverës;
 - c) semestri i verës.
2. Organizimi i procesit mësimor përcaktohet në Rregulloren e Universitetit.

Neni 68
Vlerësimi

1. Në Universitetin “Ismail Qemali”, Vlorë shkalla e përvetësimit të programit mësimor vlerësohet me sistemin prej shtatë notash: 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10. Nota më e ulët për kalim është 5 (pesë). Në listën e notave që shoqërojnë diplomën pasqyrohen vetëm notat përfundimtare kaluese më e madhe ose e barabartë me 5 (pesë).
2. Mesatarja e studentit llogaritet si mesatare e ponderuar. Shuma e produkteve të notave përfundimtare me kreditet përkatëse të lëndës pjesëtohet me totalin e krediteve të fituara me vlerësim me notë.
3. Universiteti “Ismail Qemali”, Vlorë akordon për studentët në përfundim të studimeve titujt e nderit në tri nivele, në bazë të mesatares së përgjithshme të notave si më poshtë:
 - a. 9.00 - 9.33, *cum laude*;
 - b. 9.34 - 9.67, *magna cum laude*;
 - c. 9.68 - 9.99, *summa cum laude*.
 - d. 10.00, *maxima cum laude*
4. Këta tituj lëshohen së bashku me diplomën universitare të fituar nga studenti.
5. Një student me mesatare 10 (dhjetë), *maxima cum laude*, dekorohet nga Senati Akademik me “Medalje të artë”.
6. Lëshimi i një diplome me tituj nderi nga universiteti do të bazohet vetëm në kredite të Universitetit “Ismail Qemali”, Vlorë ose në rastet kur studenti ka fituar të paktën 150 kredite në Universitetin “Ismail Qemali”, Vlorë.
7. Ceremonia e diplomimit zhvillohet për të gjitha fakultetet dhe drejtohet nga Rektori, në prani të përfaqësuesve të Senatit Akademik, të profesoratit, administratës dhe studentëve.
8. Lista e studentëve që kanë përfituar tituj nderi mbahet pranë Rektoratit, publikohet dhe përditësohet çdo vit periodikisht.

Neni 69
Transferimi i studimeve, njohja dhe njësimi i periudhave të studimit

1. Universiteti “Ismail Qemali”, Vlorë u ofron studentëve mundësi për njohjen e krediteve dhe transferimin e studimeve, midis programeve të të njëjtit cikël studimi, brenda vetë universitetit apo institucioneve të ndryshme të arsimit të lartë.
2. Transferimet lejohen brenda të njëjtit cikël studimi dhe në fusha studimi të njëjta ose të përafërta dhe vetëm në fillim të vitit akademik.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI “ISMAIL QEMALI” VLORE
SENATI AKADEMIK**

3. Kriteret e procedurat e njohjes së krediteve dhe transferimi i studimeve përcaktohen në Rregulloren e Universitetit.
4. Vendimi për njohjen e plotë ose të pjesshme të krediteve të fituara nga një student që transferohet, me qëllim vazhdimin e studimeve në një program studimi të UV-së, merret nga komisioni përkatës, i ngritur nga njësia bazë pranuese.

Neni 70

Kohëzgjatja e studimeve

1. Kohëzgjatja maksimale e studimeve në një program studimi nuk mund të jetë më shumë se dyfishi i kohëzgjatjes normale të studimeve që parashikon programi, pa marrë në konsideratë periudhën e kohës kur studenti i ka pezulluar studimet.
2. Në rast të pezullimit të studimeve, studenti, në momentin e ripranimit, i nënshtrohet programit të ofruar nga njësia bazë, në vitin akademik të ripranimit.
3. Studenti, që nuk arrin të përfundojë studimet brenda kohëzgjatjes maksimale të programit, ka të drejtë të aplikojë për të rifilluar studimet, në të njëjtin program studimi ose në një program tjetër. Ai u nënshtrohet kritereve dhe procedurave të shpallura për regjistrimin në programin e studimit të Universitetit “Ismail Qemali”, Vlorë. Kreditet e grumbulluara nga studenti gjatë periudhës së mëparshme të studimeve mund të transferohen, me vendim të njësisë bazë që pranon studentin, sipas kritereve të përcaktuara në Rregulloren e Universitetit.

Neni 71

Lëshimi i diplomave, certifikatave dhe suplementi i diplomës

1. Në përfundim të programit të studimit, studenti pajiset me diplomën ose certifikatën përkatëse të lëshuar nga Universiteti “Ismail Qemali”, Vlorë.
2. Diplomat që lëshohen në përfundim të programeve të studimit të ciklit të parë, të ciklit të dytë, si edhe ato “Master ekzekutiv” të ciklit të tretë shoqërohen me suplementin e diplomës.
3. Universiteti “Ismail Qemali”, Vlorë nuk mund të lëshojë duplikatë diplome, por mund të lëshojë dokument të barasvlefshëm me diplomën në formën e vërtetimit, i cili duhet të përmbajë emrin e universitetit, numrin e diplomës origjinale, datën e lëshimit të saj, ciklin dhe programin e studimit.
4. Suplementi i diplomës hartohet në përputhje me kërkesat e Hapësirës Evropiane të Arsimit të Lartë. Ai përshkruan, në veçanti, natyrën, nivelin, përmbajtjen dhe rezultatet e studimeve, që janë kryer nga mbajtësi i diplomës, si dhe fushën e punësimit. Forma dhe specifikat e suplementit të diplomës përcaktohet në rregulloren e UV-së, në përputhje me udhëzimet e Ministrisë përgjegjëse për Arsimin.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI “ISMAIL QEMALI” VLORË
SENATI AKADEMIK

KREU VII
STUDENTËT

Neni 72

Fitimi, pezullimi dhe humbja e statusit të studentit

1. Statusi i studentit fitohet me regjistrimin e tij në një prej programeve të ofruara nga Universiteti “Ismael Qemali” dhe vazhdon deri në momentin në të cilin studentin merr diplomën ose certifikatën përkatëse ose kur ai vendos të çregjistrohet përpara përfundimit të studimeve.
2. Studenti nuk mund të regjistrohet njëkohësisht në më shumë se një program studimi, me përjashtim të studentëve të shkëlqyer.
3. Studenti mund t’i pezullojë studimet dhe t’i rifillojë ato në përputhje me Rregulloren e institucionit.
4. Kohëzgjatja maksimale e studimeve në një program studimi nuk mund të jetë më shumë se dyfishi i kohëzgjatjes normale të studimeve që parashikon programi, pa marrë në konsideratë periudhën e kohës kur studentin i ka pezulluar studimet. Procedurat e çregjistrimit përcaktohen në Rregulloren e Universitetit.
5. Studenti, që nuk arrin të përfundojë studimet brenda kohëzgjatjes maksimale të programit, ka të drejtë të aplikojë për të rifilluar studimet në të njëjtin program studimi ose një program tjetër. Ai u nënshtrohet kritereve dhe procedurave të shpallura për regjistrimin në programin e studimit të institucionit pritës. Kreditet e grumbulluara nga studentin gjatë periudhës së mëparshme të studimeve mund të transferohen me vendim të njësisë bazë të institucionit që pranon studentin, sipas kritereve të përcaktuara në rregulloren e saj.

Neni 73

Të drejtat dhe detyrimet e studentëve

1. Studentët e Universitetit “Ismael Qemali”, Vlorë kanë të drejtë:
 - a. të ndjekin të gjitha veprimtaritë mësimore, që zhvillohen në kuadrin e programit të studimit ku studentët janë regjistruar;
 - b. të përdorin infrastrukturën e vënë në dispozicion nga Universiteti “Ismael Qemali”, Vlorë, për realizimin e procesit mësimor;
 - c. të përfitojnë nga shërbimet mbështetëse, që ofrohen nga Universiteti “Ismael Qemali”, Vlorë;
 - d. të marrin pjesë në proceset e vendimmarrjes së Universitetit “Ismael Qemali”, Vlorë, në përputhje me përcaktimet e bëra në ligjin për arsimin e lartë.
 - e. të shprehin vlerësimet e tyre për cilësinë e mësimdhënies dhe punën e personelit të universitetit;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI “ISMAIL QEMALI” VLORE
SENATI AKADEMIK**

- f. të përfitojnë bursë studimi, kur plotësojnë kushtet e përcaktuara nga Këshilli i Ministrave, si dhe shpërblime të veçanta që administrohen nga universiteti;
 - g. të sigurohen nga Universiteti “Ismail Qemali”, Vlorë në një ndër shoqëritë e sigurimit, për të gjithë kohëzgjatjen e parashikuar të studimeve, për riskun e ndërprerjes së veprimtarisë apo risqe të tjera, sipas përcaktimeve të bëra në udhëzimet e Ministrit përgjegjës të arsimit të lartë dhe Ministrit të Financave;
 - h. të organizohen në këshillat e studentëve nëpërmjet të cilave bëhet përfaqësimi i tyre në organet drejtuese të Universitetit “Ismail Qemali”, Vlorë;
 - i. të ndjekin një program të dytë studimesh brenda të njëjtit cikël, në përputhje me rregullat e parashikuara në këtë statut.
2. Detyrimet e studentëve janë:
- a. të zbatojnë rregullat e përcaktuara në Statutin dhe Rregulloren e Universitetit “Ismail Qemali”, Vlorë;
 - b. të respektojnë Kodin e Etikës së Universitetit;
 - c. të respektojnë të drejtat e personelit dhe të studentëve të tjerë;
 - d. të frekuentojnë programet e studimit sipas parashikimeve të bëra në *syllabus*-et e lëndëve, si dhe kriterëve të përcaktuara në Rregulloren e Universitetit;
 - e. të paguajnë tarifat e përcaktuara për ndjekjen e programeve të studimit, si dhe tarifat e shërbimeve të ofruara nga universiteti, brenda afateve kohore të përcaktuara në Rregulloren e tij;
 - f. të plotësojnë pyetësin për cilësinë e mësimdhënies përpara provimit përfundimtar të lëndës përkatëse.
3. Studentit përsëritës, përgjithësisht, i ndërpritet mbështetja nga fondet publike, me përjashtim të rasteve të forcave madhore.

Neni 74

Këshillat e studentëve

1. Studentët e Universitetit “Ismail Qemali”, Vlorë kanë të drejtë të organizohen në këshilla studentore në nivel njësie kryesore, në nivel universiteti, si edhe në nivel kombëtar.
2. Këshillat e studentëve janë organizime të pavarura të studentëve në universitet, të cilat nuk zhvillojnë veprimtari politike dhe ekonomike. Këto këshilla promovojnë pjesëmarrjen e studentëve dhe koordinojnë përfaqësimin e tyre në organet drejtuese të Universitetit “Ismail Qemali”, Vlorë.
3. Këshillat e studentëve zgjidhen çdo dy vjet, nga votat e studentëve dhe mbështeten në legjislacionin në fuqi. Mënyra e funksionimit të këshillave të studentëve, përcatohen në Rregulloren e Universitetit duke marrë në konsideratë propozimet e paraqitura nga studentët.
4. Këshillat e studentëve nuk mund të organizohen në struktura të tjera politike dhe jopolitike, jashtë universitetit.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI “ISMAIL QEMALI” VLORE
SENATI AKADEMIK**

5. Universiteti “Ismail Qemali”, Vlorë mbështet këshillat e studentëve dhe financo veprimtarinë e tyre.
6. Këshillat e studentëve shprehin mendime dhe propozime për të gjitha problemet me interes të përgjithshëm të institucioneve të arsimit të lartë, si për planet dhe programet e studimeve, rregulloret për veprimtaritë mësimore, të drejtën për të studiuar, cilësinë e shërbimeve, përcaktimin e tarifave të shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët, bilancet vjetore paraprake të shpenzimeve ose ndarjen e burimeve financiare, zhvillimin e veprimtarive të ndryshme kulturore, artistike, sportive etj.

Neni 75
Shfuqizohet

Neni 76
Karta e studentit

1. Studentët e Universitetit “Ismail Qemali”, Vlorë pajisen me kartën e studentit, e cila është dokument unik. Me anë të saj studentët përfitojnë shërbime me çmime të reduktuara.
2. Kriteret dhe procedurat për përgatitjen dhe lëshimin e kartës së studentit përcaktohen nga ministria përgjegjëse për arsimin e lartë.
3. Përfitimet e studentëve nga përdorimi i kartës së studentit përballohen nga fondet e parashikuara në Buxhetin e Shtetit të ministrisë përgjegjëse për arsimin e lartë ose të Bashkisë Vlorë që mbulon shërbimet e ofruara ndaj studentëve.
4. Kategoritë e shërbimeve që ofrojnë entet shtetërore përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.
5. Studentët mund të përfitojnë lehtësi nga marrëveshjet e universitetit me organizma që kanë objekt të tyre interesat studentore, si dhe me persona juridikë privatë që ofrojnë shërbime të ndryshme.

Neni 77
Koordinatori për marrëdhëniet me studentin

1. Koordinatori për marrëdhëniet me studentin është anëtar i stafit akademik të njësisë bazë, i emëruar nga drejtuesi i njësisë bazë, për të koordinuar marrëdhëniet e departamentit me studentët.
2. Koordinatori kryen promovimin e programeve të studimit të ofruara nga njësia bazë. Informon, orienton dhe këshillon studentët për veprimtarinë mësimore, kërkimore-shkencore dhe aktivitete të tjera.
3. Koordinatori ofron këshillim për zhvillimin e karrierës në njësinë bazë.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
SENATI AKADEMIK

4. Ai këshillon studentët për problematika të ndryshme dhe raporton problematikat e tyre në departament.

Neni 78

Dokumentacioni mësimor

1. Universiteti "Ismail Qemali", Vlorë mban në formë të shkruar:
 - a) regjistrin themeltar të studentëve;
 - b) regjistrin e arritjeve akademike;
 - c) regjistrin e lëshimit të diplomave dhe certifikatave.
2. Regjistrat shpërndahen nga Qendra e Shërbimeve Arsimore kundrejt tarifës përkatëse, që përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.
3. Regjistri themeltar i studentëve është dokumenti që vërteton regjistrimin e studentëve në Universitetin "Ismail Qemali", Vlorë. Çdo student pajiset me një numër unik matrikullimi, që e mban deri në marrjen e diplomës ose certifikatës, i cili pasqyrohet në këtë regjister. Regjistri themeltar depozitohet në arkivat e shtetit, sipas kuadrit ligjor në fuqi për arkivat, ndërsa kopja e njësuar me origjinalin ruhet për gjithë periudhën kohore të ekzistencës së Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë. Ai plotësohet edhe në formë elektronike.
4. Regjistri i arritjeve akademike është dokumenti që vërteton rezultatet e arritura nga çdo student i regjistruar në Universitetin "Ismail Qemali", Vlorë sipas programeve të studimit. Regjistri i arritjeve akademike depozitohet në arkivat e shtetit, sipas kuadrit ligjor në fuqi për arkivat, ndërsa kopja e njësuar me origjinalin ruhet për gjithë periudhën kohore të ekzistencës së Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë. Ai plotësohet edhe në formë elektronike.
5. Regjistri i lëshimit të diplomave dhe certifikatave është dokumenti që vërteton emërtimin e tyre prej Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë. Universiteti nëpërmjet këtij regjistri dokumenton tërheqjen e diplomës dhe suplementit të diplomës prej secilit student që ka përfunduar me sukses detyrimet akademike dhe ato të tjera institucionale.
6. Regjistri i lëshimit të diplomave dhe certifikatave depozitohet në arkivat e shtetit, sipas kuadrit ligjor në fuqi për arkivat, ndërsa kopja e njësuar me origjinalin ruhet për gjithë periudhën kohore të ekzistencës së Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë. Ai plotësohet edhe në formë elektronike.
7. Universiteti "Ismail Qemali", Vlorë plotëson elementet e regjistrave, të përcaktuara në pikën 1, të këtij neni, në përputhje me aktet nënligjore të ministrisë përgjegjëse për arsimin e lartë. Dokumentacioni, pas plotësimit përfundimtar të tij depozitohet në arkivat e shtetit, sipas kuadrit ligjor në fuqi për arkivat, ndërsa kopja e njësuar me origjinalin ruhet në arkivin e Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe Rregulloren e këtij Universiteti. Në rastin e mbylljes së veprimtarisë së Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë, regjistrat e tij, sipas përcaktimeve në pikën 1, të këtij neni, dhe çdo dokument tjetër, depozitohen në arkivat e shtetit, sipas kuadrit ligjor në fuqi për arkivat.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI “ISMAIL QEMALI” VLORE
SENATI AKADEMIK

Neni 79

Baza e të dhënave të studentëve

1. Universiteti “Ismail Qemali”, Vlorë ruan të dhënat personale të studentëve.
2. Të gjitha proceset e ruajtjes dhe përpunimit të të dhënave personale të studentëve nga Universiteti kryhen bazuar në parimin e konfidentalitetit dhe në përputhje me kërkesat e legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK**

**KREU VIII
SIGURIMI I CILËSISË**

**Neni 80
Sigurimi i brendshëm i cilësisë**

1. UV-ja harton politika dhe procedura për sigurimin e brendshëm të cilësisë. Sigurimi i brendshëm i cilësisë është vlerësimi dhe garantimi i cilësisë së ushtrimit të veprimtarisë akademike, administrative dhe financiare të institucionit. Ky vlerësim mund të kryhet sa herë të shihet e arsyeshme.
2. Sigurimi i brendshëm i cilësisë mund të kryhet i përgjithshëm ose i pjesshëm. Ai realizohet nga vetë institucioni nëpërmjet:
 - a. Strukturave hierarkike organizative të brendshme të UV-së, të cilat planifikojnë, organizojnë dhe garantojnë zbatimin e politikave, strategjive dhe procedurave për realizimin e vizionit të tij;
 - b. Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, e cila bashkëpunon dhe asiston komisionin e përhershëm për garantimin e standardeve të cilësisë së brendshme në nivel institucioni dhe në nivel njësie kryesore në kryerjen e funksioneve të tyre.
3. Në kuadër të sigurimit të jashtëm të cilësisë, UV-ja i nënshtrohet vlerësimit periodik dhe vlerësimit krahasues institucional dhe të programeve të studimit në përputhje me legjislacionin në fuqi.
4. Mënyra e funksionimit të sistemit të sigurimit të cilësisë përcaktohet në Rregulloren e Sigurimit të Cilësisë në UV.

**Neni 81
Parimet e funksionimit të sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë**

Sistemi i brendshëm i sigurimit të cilësisë mbështetet në garantimin e transparencës, në vlerësimin dhe rritjen e përdorimit të metodave bashkëkohore të mësimdhënies dhe të të nxënit, në promovimin e kulturës së rritjes së vazhdueshme, në respektimin e legjislacionit për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë.

**Neni 82
Përbërja e Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë**

1. Në UV funksionon Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, në varësi të Rektorit. Ajo përbëhet nga personel i specializuar ndihmësakademik. Kjo njësi mund të ndihmohet në veprimtarinë e saj edhe nga komisione të posaçme të ngritura nga Rektori brenda kompetenceve të tij. Kjo njësi ka për funksion kryesor bashkëpunimin për realizimin dhe



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE SENATI AKADEMIK

sigurimin e vazhdueshëm të sistemit të cilësisë të mësimdhënies dhe të kërkimit shkencor, si dhe zhvillimin cilësor të UV-së si institucion i arsimit të lartë, mbështetur në standardet shtetërore të cilësisë, si dhe në standardet dhe udhëzimet evropiane për Sigurimin e Cilësisë në HEAL.

2. Funkcionet e Njesisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë janë:
 - a. Të realizojë në praktikë politikat e Rektorit, SA-së dhe të Rektoratit në fushë të sigurimit të brendshëm të cilësisë në vlerësimin institucional dhe vlerësimin e programeve të studimit.
 - b. Të hartojë rregulloren e funksionimit të tij në formën e manualit, si dhe të gjithë dokumentacionin e nevojshëm për menaxhimin e sistemit të cilësisë në njësitë përbërëse.
 - c. Të kryejë gjithë veprimtarinë administrative (dokumentacion, pyetësor) në funksion të komisioneve, autoriteteve, organeve, personave që përfshihen me detyra konkrete në këtë fushë.
 - d. Realizon studime gjurmuese për të vlerësuar ecurinë e punësimit të studentëve dhe efikasitetin e programeve të ofruara nga institucioni i arsimit të lartë.
3. UV-ja me propozim të SA-së i propozon Bordit të Administrimit buxhetin për këtë veprimtari.
4. BA-ja përcakton në buxhetin e institucionit fondet e nevojshme për ngritjen, mirëmbajtjen dhe përmirësimin e sistemit të cilësisë.
5. Rektori i UV-së miraton të gjithë dokumentacionin për sistemin e cilësisë.
6. Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në UV ka autonomi operative dhe akses në të gjitha të dhënat e institucionit dhe publikimin e rezultateve të vlerësimit, pas miratimit nga ana e rektorit.
7. Vlerësimi i brendshëm realizohet në përputhje me udhëzimet përkatëse të ASCAL-it. Përfundimet dhe rekomandimet e vlerësimit të brendshëm mbështeten në analizën statistikore të të dhënave, në konstatimet e nxjerra nga regjistrat, sondazhet, pyetësorët dhe intervistat e organizuara me stafin akademik, stafin ndihmësakademik dhe administrativ si dhe studentët.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK**

**KREU IX
KËRKIMI SHKENCOR**

Neni 83

Veprimtaria kërkimore-shkencore

1. UV zhvillon veprimtari kërkimore-shkencore bazë ose të zbatuara, studime, projekte për zhvillim dhe veprimtari të tjera krijuese.
2. Veprimtaritë e kërkimit shkencor në UV realizohen mbi bazën e programeve dhe projekteve të hartuara nga departamentet dhe të miratuara nga Rektorati.
3. Fushat, drejtimet, vëllimi i punës dhe afatet e veprimtarisë kërkimore-shkencore përcaktohen nga njësitë bazë dhe ato kryesore, bazuar në fushat prioritare të zhvillimit kombëtar dhe në programet e ofruara dhe në fund marrin miratimin e SA.
4. UV dhe strukturat e tij, hartojnë programe dhe projekte kërkimore në bashkëpunim me institucione të tjera publike ose private, brenda dhe jashtë vendit.

Neni 84

Kërkimi shkencor me ose për të tretët

1. UV nëpërmjet strukturave të tij, u ofron të tretëve ose pranon oferta për kërkim shkencor, ekspertizë shkencore, shërbime e të tjera, duke ndjekur procedurat e miratimit dhe kontribuar financiarisht sipas marrëveshjeve e në përputhje me Rregulloren e Universitetit.
2. Kur nga kërkimi shkencor apo shërbimet për të tretët krijohen të ardhura, ato ndahen mes institucionit që ofron shërbimin dhe personelit të përfshirë në të sipas rregullave përkatëse.

Neni 85

Financimi i kërkimit shkencor

1. Financimi i kërkimit shkencor realizohet me të ardhurat e vetë institucionit, donacione dhe burime të tjera të ligjshme si dhe nga granti i punës kërkimore shkencore që shpërndahet nga AKKSHI mbi bazën e konkurimit të projekteve.
2. Universiteti "Ismail Qemali" përcjell pranë AKKSHI çdo projekt shkencor të ardhur nga njësitë bazë të tij pas vlerësimit paraprak nga ana e Rektoratit.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK**

KREU X

AUTONOMIA FINANCIARE

Neni 86

Pronat dhe burimet e financimit

1. Autonomia financiare është kusht për ruajtjen dhe zhvillimin e mëtejshëm të lirisë akademike dhe vetorganizuese të UV-së.
2. Burimet e financimit të universitetit janë:
 - a. buxheti i shtetit;
 - b. pagesat e studentëve për arsimim;
 - c. të ardhurat për shërbimet e kryera;
 - d. të ardhurat e krijuara nga marrëdhëniet me palët e treta;
 - e. donacione dhe burime të tjera të ligjshme financimi;
 - f. veprimtari kërkimore-shkencore.
3. Të gjitha të ardhurat e krijuara nga universiteti përdoren sipas kërkesave dhe nevojave të vetë institucionit dhe pjesa e mbetur mbartet në vitin pasardhës.
4. Rektorati i propozon Bordit të Administrimit mënyrën e ndarjes së të ardhurave të përfituara nga kryerja e veprimtarive/shërbimeve të institucionit me pjesëmarrjen e personelit akademik.
5. UV-ja ka të drejtën e përdorimit dhe administrimit të pronave të paluajtshme në të cilat zhvillon veprimtarinë duke ruajtur destinacionin e tyre.
6. Të gjitha pronat e luajtshme përfshirë të drejtën e autorësisë sipas rasteve përkatëse, janë pronësi ekskluzive e UV-së.

Neni 87

Hartimi, miratimi dhe zbatimi i buxhetit

1. Rektorati harton dhe përcjell për diskutim në Senatin Akademik planin buxhetor afatmesëm i cili miratohet nga Bordi i Administrimit.
2. Në zbatim të planit buxhetor afatmesëm, njësitë kryesore dhe njësitë bazë i drejtojnë Administratorit të institucionit propozimet përkatëse për projektbuxhetin e vitit pasardhës brenda datës 30 qershor të vitit ushtrimor përkatës.
3. Administratori harton projektbuxhetin të shoqëruar me relacion dhe e shtron për diskutim në Rektorat.
4. Rektorati ka të drejtë të propozojë ndryshime në projektbuxhetin e hartuar nga ana e Administratorit të institucionit.
5. Ky projektbuxhet i përcillet Senatit Akademik, i cili gjithashtu ka të drejtë që me shumicë të thjeshtë dhe votim të hapur të bëjë ndryshime në projektbuxhet.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI “ISMAIL QEMALI” VLORE
SENATI AKADEMIK**

6. Përfundimisht, projektbuxheti i përcillet për miratim Bordit të Administrimit.
7. Zbatimi i buxhetit ndiqet dhe kontrollohet nga Administratori i institucionit.

Neni 88

Kontrolli i brendshëm

1. Kontrolli dhe auditimi i brendshëm në UV dhe në njësitë e tij përbërëse realizohen nga njësia e auditimit të brendshëm të UV-së e cila është në varësi të BA-së.
2. Përbërja dhe mënyra e funksionimit të kësaj njësie përcaktohet në rregulloren përkatëse të saj të miratuar nga Bordi i Administrimit.

Neni 89

Pronat e UV-së

1. UV-ja administron pronat e paluajtshme në të cilat ajo ushtron veprimtarinë e saj.
2. UV-ja ruan dhe mirëmban pronat në administrim dhe nuk mund të ndryshojë destinacionin e tyre.
3. UV-ja mund të zhvillojnë pronat me miratim paraprak të Këshillit të Ministrave, pas propozimit të ministrit përgjegjës për arsimin.

Neni 90

Vula, stema dhe rregullorja

1. Universiteti “Ismail Qemali”, Vlorë ka vulën zyrtare sipas modelit të miratuar nga Këshilli i Ministrave. Vula ka diametrin 40 mm, me stemën shtetërore në qendër dhe rreth saj në pjesën e lartme shënohet: “REPUBLIKA E SHQIPËRISË”, ndërsa në pjesën e poshtme “UNIVERSITETI “ISMAIL QEMALI”, VLORE” (sipas modelit 1, bashkëngjitur).
2. Universiteti ka për simbol të tij stemën e tij (modeli 2, bashkëngjitur).
3. Fakultetet e UV-së kanë vulat e tyre zyrtare dhe miratojnë stemat përkatëse, nisur nga modeli i stemës së UV-së.
4. UV-ja ka faqen zyrtare të internetit me adresë: www.univlora.edu.al.
5. Në përputhje me ligjin nr. 80, datë 22. 07. 2015, “Për Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe në përputhje me këtë Statut, hartohet Rregullorja e Universitetit “Ismail Qemali”, Vlorë si dhe rregullat dhe akte të tjera në zbatim të këtij Statuti.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK**

**KREU XI
PROCEDURAT ZGJEDHORE**

**Neni 91
Procedura të zgjedhjeve në UV**

1. Zgjedhjet për autoritetet dhe organet drejtuese të UV-së zhvillohen sipas përcaktimeve të bëra në ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015, "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën Shqipërisë" dhe në Rregulloren e Zgjedhjeve të Universitetit, në të cilën përcaktohen kriteret për hartimin e listave zgjedhore, regjistrimin e kandidatëve, procesin e votimit, kriteret e vlefshmërisë e të numërimit të votave, rregullat për shpalljen e rezultatit dhe të fituesve, procesin dhe afatet e ankimit.
2. Rregullorja për zgjedhjet e para, sipas ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015, "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", të autoriteteve dhe organeve drejtuese të institucioneve të arsimit të lartë publik, miratohet nga ministria përgjegjëse për arsimin.

**KREU XII
DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT**

**Neni 92
Miratimi i rregulloreve**

1. Senati Akademik brenda 2 muajve nga hyrja në fuqi e këtij Statuti, me propozim të Rektoratit miraton Rregulloren e brendshme të Universitetit. Në Rregulloren e brendshme të Universitetit, aktet e brendshme të tij dhe rregulloret e programeve të studimit, dispozitat e këtij Statuti zgjerohen me përcaktime të tjera me qëllim rregullimin dhe disiplinimin e veprimtarisë, praktikave dhe vendimarrjeve të përditshme të autoriteteve, organeve drejtuese dhe strukturave të tij.
2. Rregulloret e tjera të parashikuara nga ligji dhe ky Statut, miratohen nga organet përkatëse, brenda një muaji nga miratimi i Rregulloreve të UV-së.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK**

**Neni 93
Shfuqizime**

1. Me hyrjen në fuqi të këtij Statuti, shfuqizohet Statuti i mëparshëm i miratuar nga Senati Akademik në mbledhjen e datës 22.07.2013 me të gjitha ndryshimet e mëvonshme.
2. Aktet e tjera të brendshme të dala në zbatim të Statutit të mëparshëm duke filluar nga Rregullorja e Universitetit qëndrojnë në fuqi për aq sa nuk bien ndesh me këtë Statut, deri në miratimin e akteve të reja të brendshme.
3. Çdo nen që është në kundërshtim me ligjin dhe aktet nënligjore të miratuara për zbatimin e tij, shfuqizohet.

**Neni 94
Hyrja në fuqi**

1. Statuti hyn në fuqi pas miratimit nga ministria përgjegjëse për arsimin, sipas parashikimeve të nenit 33 të ligjit 80/2015.
2. Nëse ministri ia kthen këtë Statut për ripunim UV-së, për mospërputhje të tij me ligjin, atëherë brenda 5 (pesë) ditëve nga kthimi i Statutit, Senati Akademik mblidhet për të shqyrtuar dhe miratuar ndryshimet përkatëse. Edhe në këtë rast procedura është e njëjtë me atë të përcaktuar në pikën 2, të nenit 33, të ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015, "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë". Nëse krijohet konflikt që nuk zgjidhet me mirëkuptim, Universiteti "Ismail Qemali", Vlorë rezervon të drejtën, që me vendim të Senatit Akademik, të kundërshtojë sipas rregullave ligjore për aktet administrative.

KRYETAR I SENATIT AKADEMIK TË UV

PROF. DR. AURELA SALIAJ



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI “ISMAIL QEMALI” VLORË

ANEKS I

STEMA






UNIVERSITETI “ISMAIL QEMALI” VLORE
SENATI AKADEMIK


ANEKS II

VULA



ANEKSI III

ORGANIGRAMA E UNIVERSITETIT 'ISMAIL QEMALI'





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE

LEGIJENDA:

QKSH:	Qendra kërkimore- shkencore e Shëndetit Publik;
DI:	Departamenti i Infermierisë;
DKSH:	Departamenti i Kujdesit Shëndetësor;
QKSH:	Qendra kërkimore - shkencore e Albanologjisë dhe Ballkanistikës.
DD:	Departamenti i Drejtësisë;
DE:	Departamenti i Edukimit;
DGJH:	Departamenti i Gjuhëve të Huaja;
DGJL:	Departamenti i Gjuhës Shqipe dhe Letërsisë;
QKSH:	Qendra kërkimore - shkencore për Inovacion dhe Teknologji;
DB:	Departamenti i Biznesit;
DFK:	Departamenti i Financës dhe Kontabilitetit;
DE:	Departamenti i Ekonomiksit;
QKSH:	Qendra kërkimore - shkencore në Shkencat e Aplikuara;
DITD:	Departamenti i Inxhinierive dhe Teknologjisë Detare;
DMF:	Departamenti i Matematikës dhe Fizikës;
DK:	Departamenti i Kimisë.
DB:	Departamenti i Biologjisë;
DSHD:	Departamenti i Shkencave Detare;
DSHK:	Departamenti i Shkencave Kompjuterike;

